REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 90/22
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 14. 04. 2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **28 prill 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 mars 2022;
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane;
4. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me Draft-Rregulloren për Organizmin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane;
5. Shqyrtimi i Raportit të aksionarëve për punën njëvjeçare të Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave "Uniteti";
6. Shqyrtimi i kërkesës i Këshillit të Bashkësisë Islame lidhur me rishikimin e memorandumit për shërbime të varrimit;
7. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për lirim nga pagesa e taksës komunale për kiosqet nga druri;
8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;
9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
10. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 90/22
Nr. i fq. / Br. st -2-
Data: / Datum 14.4.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Melihate Basholli Latifi** ________<br><br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Sekretarisë së kuvendit** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 13.4.2022** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **13 prill 2022** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të përmirësohen disa gabime teknike dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të përmirësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me Draft-Rregulloren për Organizmin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i Raportit të aksionarëve për punën njëvjeçare të Ndërmarrjes regjionale për menaxhimin e mbeturinave "Uniteti".
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Shqyrtimi i kërkesës i Këshillit të Bashkësisë Islame lidhur me rishikimin e memorandumit për shërbime të varrimit.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që kësaj kërkese t'i bashkëngjitet memorandumi paraprak dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Propozim - vendimit për lirim nga pagesa e taksës komunale për kiosqet nga druri.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

# P R O C E S V E R B A L
# NGA MBLEDHJA E II E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 MARS 2022

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën* ***10:15.***

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**paraqiti disa kërkesa të fshatit Akrashticë, që vlerësoi se kanë urgjencën e trajtimit të tyre dhe janë të nevojës reale për tu realizuar. Këto kërkesa lidhen me dy rrugë kryesore të këtij fshati rrugua “Vullnetari i UÇK-së”, dhe rr. “Qazim Morina” të cilat janë në gjendje të mjerueshme, për faktin se asfaltimi jo kualitativ që është bërë para 10 apo 15 viteve kanë bërë që këto rrugë të shkatërrohen. Këtyre rrugëve duhet dhënë prioritet për faktin se janë rrugë apo arterie kryesore të këtij fshati, andaj duke marrë për bazë gjendjen financiare të komunës duhet bërë përpjekje që për këtë vit këto rrugë të riparohen për aq sa është e mundur. Po ashtu lagja “Zeqa” dhe lagja “Mehana” tek lumi apo prrocka Drejtoria e Urbanizimit të ketë prioritet asfaltimin e rrugëve në këto lagje. Mandej kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të kenë parasysh kyçjen në rrjetin e ujësjellësit të lagjes “Gashi” kjo duhet të trajtohet me prioritet tek zgjerimi i ujësjellësit.
**Nurie Halili, anëtare e kuvendit-**kërkoj nga komuna gjegjësisht Drejtoria e Inspektimeve, që marrë masa për zbatimin e rregullores për orarin e punës për bizneset private, duke respektuar sidomos vikendet si ditë pushimi ashtu edhe siç parashihe në rregullore. Kjo është kërkesë e shumë bizneseve e sidomos e punëtorëve në sektorin privat. Zbatimi i kësaj rregullore kishte filluar të

zbatohet në vitin 2020 dhe kishte dhënë efekte pozitive në aspektin e respektimit të orari të punës dhe në mbrojtjen e punëtorëve. Në këtë kontekst ajo kërkoj që rregullorja të filloj të zbatohet pas muajit të shenjët të Ramazanit nga e diela e parë që i bie me datën 9 maj 2022.
**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit-**kërkoj që të zbatohet rregullorja për orarin e punës për bizneset private, ashtu që dita e diel të jetë ditë pushimi. Pastaj kërkoj nga komuna që të gjenden fondet për përfundimin e rregullimi të rrugës "2 maji" e cila është dëmtuar tej mase dhe për këtë më së tepërmi po pësojnë qytetaret e atij lokaliteti.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**përsëriti kërkesën e tij për të cilin deklaroi për shumë herë më radhe se nga asnjë qeveri nuk është ndërmarr asnjë veprim, kërkesa e tij lidhet me hedhjen dhe gjuajtjen e mbeturinave në fushën e fshatit Pasomë, ku siç deklaroi aty është duke u marrë një invazion nga mbeturinat inerte. Këtë kërkesë e ka potencuar disa herë sepse ajo rrugë nuk ka të bëj vetëm me fshatin Pasomë por lidh pjesën e rajonit të Shalës së Bajgorës, në këtë kontekst kërkoj që formohet një komision që ta vizitoj atë territor. Kërkoj që sa më parë të merren masa për largimin e atyre mbeturinave dhe ajo sipërfaqe të kthehet sikur ka qenë dikur tokë e pëlleshme e mbjellë me kultura bujqësore. Në fund ai kërkoi nga organet kompetente komunale, që të dalin në teren për ta inspektuar gjendjen dhe për të ndërmarr masat e duhura lidhur me këtë problematikë.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**pasi i përshëndeti të pranishmit në adresim para kuvendit paraqiti përgjigje në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit ku ndër të tjera shtoi se sa i përket rrugëve në fshatin Akrashticë por edhe rrugë tjera që janë dëmtuar, do të futen tek kodi ekonomik rikonstruktimi i rrugëve në kuadër të buxhetit të komunës dhe do të trajtohen me prioritet. Sa i përket propozimit për respektimin e orarit të punës dhe zbatimin e rregullores që e diela të jetë ditë pushimi në sektorin privat potencoi se plotësisht pajtohet me një propozim të tillë dhe kërkoi nga organet e inspektorati që të inspektojnë në teren dhe ta zbatojnë rregulloren. Lidhu me propozimin për ndërtimin e rrugës "2 maji" njoftoi se ky projekt vetëm se ndodhet në procedurat e tenderimit dhe ka shpresë se do të përfundohet brenda një afati të arsyeshëm. Për sa i takon hedhjes së mbeturinave në fushat në fshatin Pasomë dhe Banjësk, njoftoi se organet komunale kanë dal në teren dhe e kanë inspektuar, atje është konstatuar se kemi tri deponi ilegale njëra prej tyre gjendet në kodrat e fshati Banjësk që është më e madhja, mandej në rrugën për fshatin Skoçanë dhe në fshatin Pestovë. Lidhur me këtë problematikë ai u zotua se posa të alokohet buxheti i komunës do të shpallet një tender për eliminimin e këtyre deponive.
**Benjamin Shala drejtor i DSHP-së-**paraqiti sqarime duke u përgjigjur në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**sugjeroi që para se të bëhet rikonstruktimi dhe asfaltimi i rrugës "2 maji" të bëhet riparimi i gypit të ujësjellësit. Ndërsa sa i përket riparimit të rrugës në fshatin Pasomë sqaroi se ekziston një kontratë mes komunës dhe operatorëve ekonomik për riparimin e asaj rruge dhe kjo mundësi mund të shfrytëzohet.
**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit –**njoftoi se pika e shtatë e rendit të ditës largohet nga rendi i ditës, pasi që materiali mungon por edhe mungon konfirmimi i ministrisë së linjës për bartjen e mjeteve financiare nga viti 2021 në vitin 2022. Ndërsa në pikën në të ndryshme shtohet plotësimi i vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut për prodhues vendor. Njëkohësisht edhe pika nëntë e rendit të ditës hiqet nga shqyrtimi dhe shtyhet për një mbledhje tjetër.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**arsyetoj se propozimi që lidhet me caktimin e lokacionit për tregun e gjelbër, njoftoi se nevojitet një votim formal për ta plotësuar preambulën e vendimit referenca në Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Plani Zhvillimor Komunal. Ndërsa sa i përket vendimit për caktimin e lokacioneve për çerdhet njoftoi se është kërkesë e Ministrisë së Arsimit

që caktohet këto lokacione ashtu që të hapet rruga për investime, kjo temë mund të futet në rend të ditës por edhe mund të shtyhet.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi këtë:**

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 j shkurt 2022;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2022;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomike – financiare dhe zbatimin e planeve investuese, i punës së Kryetarit të komunës – ekzekutivit për vitin 2021;
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;
6. Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për shërbimet e çerdheve publike;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë;
12. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 01-54/22 i datës 24.02.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër në Komunën e Vushtrrisë;
13. Të ndryshme.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 j shkurt 2022;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 24 shkurt 2022.**

**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2022;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota 34 vota "për" ndërsa 1 votë "abstenim" (Spasoje Stefanoviq), aprovoi procesverbalin nga mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 5 mars 2022.**

**3.** Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomike – financiare dhe zbatimin e planeve investuese, i punës së Kryetarit të komunës – ekzekutivit për vitin 2021;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se është shqetësuese mos inicimi dhe dështimi i shumë projekteve kapitale, por edhe projekteve që kanë bëjnë me blerjen e shërbimeve si rezultat i dështimit të sistemit të prokurimit publik ku shumë mjete financiare të komunë kanë shkuar në suficit ndërsa kemi mungesa prej me të ndryshmeve për kushte pune dhe mungesë të zhvillimit të projekteve e në këtë rrjedh edhe mungesë të zhvillimit ekonomik. Tutje listoj disa nga projektet të cilat fare nuk janë iniciuar për shpallje në procedurat e prokurimit, si ato të teknologjisë informative, pastaj aparatet kundër zjarrit nuk kemi procedura të prokurimit, edhe pse çdo vit kemi probleme me zjarret, djegjën e pyjeve, pastaj inventarizimi i shtëpisë së kulturës, furnizimi dhe montimi i ulëseve për nxënësit në oborret e shkollave. Mandej mjete e konkretizimit, furnizimi me pajisje dhe veshmbathje: mantila, kapela, maska në kohë pandemi nuk është iniciuar. Furnizimi me sera, furnizimi dhe ngritja e pemishteve nuk është realizuar. Shqetësuese është mos furnizimi me oksigjen në qendrat e mjekësisë është kjo tepët e rrezikshme pasi interferon në shkaktimin e mundësimeve për vdekjen e pacientëve. Furnizimi dhe veshmbathja e stafit në QKMF, furnizimi me material shpenzues në laborator, ku jemi gjendur në situatë krize kur laboratori i ka kufizuar thuajse në minimum analizat e këtu shohim se fare nuk është proceduar furnizimi me reagenca dhe gjëra tjera laboratorike furnizimi me pajisje mjekësore. Tutej DDD-ja nuk është iniciuar edhe pse është obligim ligjor, në këtë rast pyeti se a ka bërë komuna deratzim, dezinfektim dhe dezisektim në institucionet publike nëse jo a ka bërë shkelje ligjore dhe kujt i mbetet përgjegjësia për këtë çështje. Servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit a janë funksional nëse nuk janë servisuar pasi që kontrata ka dështuar. Shërbimet e konsulencës janë realizuar me sukses sepse këtu ka pasur angazhim me kontratë mbi vepër. Pas vërshimeve që ka pasur vitin e kaluar, janë planifikuar mjetet për rregullimin e argjinaturave të lumjaneve, por edhe ky projekt ka shkuar në suficit. Për vite të tëra ka qenë vërejtje e auditorit të përgjithshëm për mungesë të depove për vendosjen e materialeve nëpër shkolla por edhe ky projekt ka dështuar dhe mjetet kanë shkuar në suficit, asfaltimi i rrugë Sllakoc-Kurillov po ashtu nuk është iniciuar.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**kërkoi që bëhet korrigjimi i rekomandimeve të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa. Lidhur me raportin ceku se ka disa gabime teknike për të cilat kërko që të korrigjohen. Tek prokurimi publik kontrata për furnizim nga 55 aktivitete sa kanë qenë të planifikuar për inicim, 27 prej tyre janë iniciuar apo realizuar që në përqindje i bie se 49 % janë realizuar, ndërsa 28 prej tyre fare nuk janë iniciuar dhe këto projekte kanë dështuar që në përqindje është 51 %. Pastaj tek kontratat për shërbime nga 27 projektet sa janë planifikuar, janë iniciuar 12 ose 44.45 %, kurse nuk janë iniciuar 15 ose 55.55 % kanë dështuar. Tek kontrata për punë janë paraparë gjithsejtë 28 projekte prej tyre janë iniciuar 13 ose 46.4 % kurse nuk janë realizuar 15 projekte ose 53.6 %. Marr në tërësi nga 110 projekte sa janë planifikuar, janë iniciuar apo realizuar 52 prej tyre apo 47.27 %, kurse 58 prej tyre nuk janë iniciuar fare apo shprehur ndryshe i bie se 52.80 % e tyre nuk janë realizuar. Nga ajo çka shihet del në pah se nuk kemi nivel të kënaqshëm të realizimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontraktimit të punëve. Përkundër kësaj në raport thuhet se kemi një përmbushje të planit prej 60.50 % gjë e cila është e paqëndrueshme sepse realizimi është në masën prej 47.27 %. Mandej në raport thuhet se katër operator ekonomik janë penalizuar për shkak të mos realizmit të punëve sipas afatitl, ndërsa vlera e këtyre penaltive është 1215 €, në këtë rast është mirë që të evidentohen se cilët janë ata operator ekonomik që janë të papërgjegjshëm dhe të njoftohen edhe anëtarët e kuvendit. Në faqe 14 të raportit kërkoi që të bëhet korrigjimi i disa gabimeve teknike sa i përket viteve për parfumimin e

vitit shkollor, por edhe sa i përket numrit të nxënësve. Tek rezultatet e arritur në nivelin republikan thuhet se ekipet sportive shkollore në gara pingpong pa plasman, d.m.th në këtë rast e rëndësishme paska qenë pjesëmarrja e jo plasmani. Tek suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2021/2022 thuhet se në klasës X,XI dhe XII janë 11,665 nxënës, ndërsa në realitet janë 2548 nxënës. Mandej tek nxënësit e shkëlqyeshëm tek klasat e X kemi 69 të shkëlqyeshëm, klasët XI 67 ndërsa tek klasët e XII kemi 104 nxënës të shkëlqyeshëm apo në total janë 240, ndërsa në raport thuhet se nxënës të shkëlqyeshëm janë 4581, pra ky është një gabim drastik statistikor. Tek shërbimet publike thuhet se në projekt për furnizim kanë qenë 9000 familje dhe deri tash janë kyçur ekonomit familjare të pesë fshatrave dhe mandej numërohen 17 fshatra, kjo tregon se problemi me furnizim me ujë të pijshëm është një problem që po na përcjellë vit pas viti dhe është imediatet që të mëremi me këtë çështje. Lidhu me ujërat e zeza thuhet se në fshatin Stanoc i Epërm lagja "Shala" është rregulluar një kanalizim në gjatësi prej 650 metra, për këtë nuk njohuri dhe kjo është mirë të shpjegohet pastaj në fshatin Stanoc i Epëm thuhet se janë shtuar 2105 metra këtu është mirë të specifikohet se në cilat lagje janë është nderuar ky kanalizim.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se në këtë raport nuk kemi se çfarë të shtojmë e as çfarë të heqim pasi që i njëjti i takon qeverisës së kaluar, por e vërtet është se anëtarët e LVV-së janë duke bërë gara njëri me tjetrin për ti parashtrua dështimet e tyre që kanë bashkë qeverisur me LDK-në.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se duhet kuptuar se LVV-ja e kishte shkëputur bashkëpunimin me LDK-në qysh në janar të vitit 2021 dhe për mos realizim të buxhetit as që mund të akuzohet pasi që në atë kohe akoma nuk ka qenë i alokuar buxheti, dhe këtu ekziston dallimi mes LVV-së dhe Nismës Social Demokratet që e përfaqëson Bekim Zarbrgja, ku kjo parti ka qëndruar deri në fund në koalicion me Xhafer Tahirin dhe bile ka vallëzuar me të.
**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit-** pyeti se deri ku ka shkuar projekti me furnizim me motokultivator, pasi që aplikantet kanë realizuar participimin e tyre por akoma nuk janë furnizuar me këto makina.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që ta zbatoj rregulloren e punës së kuvendit, ashtu që për një pikë të rendit të ditës mos të ia jap fjalën dy herë të njëjtit anëtarë të kuvendit.
**Hyda Dallku, drejtor i DP-së-**paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë duke u përgjigjur në temat dhe pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ai vlerësoi se të gjitha suksese dhe dështimet i atribuohen dikujt tjetër i cili tashëm nuk ka është në udhëheqje të komunës. Për më tepër ai njoftoi kuvendit me procedurat e prokurimit dhe me kontrata që tashmë i ka lidhur Komuna e Vushtrrisë me operatoret ekonomik. Sa i përket kontratës për furnizim me motokultivator njoftoi se kjo kontratë dhe komuna është duke e pritur vendimin e OSHP-së.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se jo vetëm këtë vit por edhe vitin e kaluar komunat e Kosovës kanë probleme me OSHP-në, dhe kjo është njëra prej arsyeve që vitin e kaluar shumë projektet kapitale kanë dështuar. Andaj tani nuk duhet tentuar të hedhim fajin nga subjekt politike tek tjetri duke luajtur rolin e bajraktarizmit politik, sepse zgjedhjet e fundit i kanë treguar vendit secilit subjekt politik. Ai tërhiqi vëmendjen se edhe kjo qeveri do të ketë problem me OSHP-në dhe kjo do të reflektoj në shpenzimin e buxhetit të komunës.

**4.** Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022;

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se kur flasim për raportin statistikor nuk duhet orientuar vetëm në ofrimin e disa statistikave apo një grumbull numrash, por duhet bërë analizë krahasimore për të nxjerr ndonjë konkluzion lidhur me ndonjë dukuri negative apo ndonjë përparësi. Në raportin

e ofruar nga DKA-ja nuk ka sugjerim as nuk ka përfundime dhe konkluzione se si do të përmirësohet gjendja në arsimin e Komunës së Vushtrrisë. Në raport përshkruhen renovimi-meremetimi, ndërtimi dhe ndërrimi i pajisjeve në shkollat e komunës, e puna e DKA-së nuk përfundon me kaq. Pastaj tha se kushtet materiale në infrastrukturën shkollore janë tepër të nevojshme, por jo të domosdoshme për të ngritur performancë dhe cilësinë në arsim. Sa i përket suksesit vërehet se ka konstruksion në sukses dhe ai sukses është jo real dhe jo i vërtet sepse në klasët I-V të shkollave fillore kemi me sukses të shkëlqyeshëm 65 %, në klasën e parë (I) shkollës fillore 86% janë të shkëlqyeshëm, pastaj në klasët VI- IX rezultati i shkëlqyeshëm i nxënësve bie në 28 %, ndërsa në shkollën e mesme 18 % dhe kjo është e tmerrshme sepse tregon se ky sukses nuk është real, lidhur me këtë gjendje Drejtoria e Arsimit duhet të ndale seriozisht të merret me këtë çështje pasi që diçka vërtet nuk është duke funksionuar. Pastaj kemi 129 nxënës me ngecje në zhvillim dhe vetëm 3 mësues merren me këta fëmijë. Janë 8 shkolla me ma pak se 10 nxënës për një klasë dhe imagjinon se çfarë mësimi mund të zhvillohet në këto shkolla dhe klasë ose në rastin më të keq kur kemi klasë dhe mësimi të kombinuar. Andaj ju adresua kryetarit të komunës se duhet që në një afat sa më të arsyeshëm të ofroj një plan zhvillimor të Arsimit dhe të ndërmerren veprime sa më shpejt që ndryshohet gjendje në arsim jo duke akomoduar interesa vende pune për ndonjë mësimdhënës por duke ngritur kapacitetet e mësimnxënies tek nxënëset dhe ngritja e cilësisë në arsim. Në fund lidhur me emërimin e shkollave, vlerësoi se shumë shkolla janë pa emër dhe pyeti se kur do të emërohen ato.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**kërkoj të bëhen disa korrigjime në informatë që lidhen me emërtimin e Ministrisë së Arsimit që akronimit MASHT ti shtohet shkronja I sepse tani është MASHTI. Pastaj kërkoj të korrigjohet data e fillimit të vitit shkollor jo me 14 shtator por procesi mësimor ka filluar më datën 27 shtator 2021 dhe që deri në atë kohë asnjë shkollë në Republikën e Kosovës nuk ka punuar si pasoj i rritjes së numrit me të prekurit nga covid-19. Rregullimi i ngrohjes qendrore në vlerë prej 22,000.00 € duhet të specifikohet se në cilat shkolla janë instaluar nxehjet, ndërtimi i rrethojave të shkollave 20,000.00 € duhet të dihet se në cilat shkolla janë realizuar këto projekte të rrethojave, ndërtimi i fushave sportive 30,000.00 €, ndërtimi i tualeteve 25,000.00 €, meremetimi 65,000.00 € në këto raste duhet bëhet specifikimi i secilës shkollë se ku janë kryer këto projekte. Ka disa prej shkollave që emërohen me emër të fshatit ku gjenden, andaj mirë kishte me qenë që shkollat të emërohen pasi që kemi mjaft personalitet të dëshmuara që meritojnë që shkollat të mbajnë emrin e tyre. Në vazhdim ai adresoj disa pyetje për Drejtoreshën e Arsimit, sa shkolla ka në Komunën e Vushtrrisë duke përfshirë këtu çerdhet publik dhe private, para filloret, shkollat fillore, shkollat e kombinuara fillore dhe të mesme të ulëta, shkolla të mesme të ulëta, shkolla të mesme të larta paralele të ndara e të tjera? Sa është numri i punëtorëve në Komunën e Vushtrrisë, prej tyre sa janë mësimdhënës, staf administrativ, staf ndihmës. Për shkak të pandemisë mësimdhënësit që kanë qenë me sëmundje të ndryshme është bërë zëvendësimi i tyre, por si është bërë zëvendësimi i tyre të cilët nuk punojnë për shkak të pandemisë? A janë plotësuar më kohë vendet e lira të punës për edukator, mësimdhënës të ciklit I-V, VI-IX, X-XII, për bibliotekistë e staf ndihmës? A kemi kuadër të planifikuar që punon nëpër shkollat e Vushtrrisë, apo kemi edhe mungesë kuadri në ndonjë lëndë mësimore. Në informatë nuk është paraqitur numri i mungesave të nxënësve që paraqet një problem në veti dhe nuk janë paraparë masat që duhet ndërmarr për zvogëlimin e tyre. Sa janë të pajisura shkollat tona me pajisje teknologjike si: kompjuter , lap-top dhe tableta për organizimin e mësimit në distancë. Në kuadër të DKA-së a ekziston ekipi kundër braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në shkolla sidomos në shkollat e mesme përfshirë klasë e X-dhjeta, në informatë nuk kemi të dhëna për shkollën e muzikës dhe për shkollën e mesme të lartë private “Viciana”. A mbahen mbledhjet e rregullta me drejtoret e

shkollave me qëllim të llogaridhënies, ndarjes së përgjegjësive dhe marrjes së vendimeve të përbashkëta. Duke ditur se vlerësimi është proces indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor kjo informatë konstaton gjendjen e tanishme në arsim por nuk përcakton objektivat për të ardhmen që do të reflektonte pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë në procesin edukativo-arsimor.

**Galip Audiu, anëtar i kuvendit**—pasi i përshëndeti të pranishmit tha se në këtë seancë të kuvendit Drejtoria e Arsimit e ka sjellë një informatë për periodën e parë të vitit shkollor 2021/22. Duke u bazuar në materialet e paraqitura në informatë, shihet qartë, se DKA ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera siç janë: Kryetari i Komunës, sektori i Inspektoratit në Mitrovicë si dhe Ministrinë e Arsimit. Po ashtu në informatë janë prezantuar mjaftë mirë objektivat, zhvillimet, aktivitetet dhe të arriturat brenda kësaj periudhe. Fillimi i vitit shkollor 2021/22 siç dihet filloi me vonesë për shkak të pandemisë covid19, por ditët humbura tashmë janë mbajtur dhe procesi arsimor në përgjithësi ka shkuar në rregulle. Materialet e sjellura nga DKA flasin konkretisht për se cilin nivel shkollor, nga parafillorët e deri te shkollat e mesme të larta, madje për secilën shkollë veç e veç, për gjendjen e shkollave, investimet që janë realizuar, numrin e nxënësve, aktivitetet brenda dhe jashtë shkollave, trajnimet e mësimdhënësve etj. Një gjë që më la shumë përshtypje pozitive, është që disa nga shkollat kanë realizuar projekte të fituara nga organizata të ndryshme, duke sjellur investime konkrete, e që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e mësimdhënies dhe mësim nxënies. E kjo tregon se disa nga drejtorët nuk kanë pritur vetëm buxhetin që ju ka nda nga komuna, por kanë hulumtuar dhe kanë gjetur donacione të reja. Me këtë rast dua ti inkurajoi drejtorët e këtyre shkollave, për përkushtimin maksimal të tyre. Po ashtu në raport vihet në pah se disa nga bizneset këtu në Vushtrri, por edhe nga mërgimtaret tan në diasporë, në një formë apo tjetër, i kanë përkrahur shkollat për mes donacioneve të ndryshme. Dua ta përmendi dhe njëkohësisht ta falënderoj Abdullah Kovaçin me qëndrim në Gjermani, i cili për të disatën herë po e ndihmon shkollën fillore “Emin Duraku” në Novolan. Po ashtu edhe profesori Raif Mehmeti me qëndrim në Suedi, e ndihmon Gjimnazin e “Eqrem Çabej” me donacione po thuajse për çdo vit. Shkolla fillore “Rexhep Musa” në Ceceli ka pranuar donacione nga IADK dhe Emona Center. Mandej Shkolla fillore “Mustafë Shyti” në Oshlan ka pranuar donacione nga ETC. Duhet theksuar që shumica e shkollave janë pajisur me mikro-bit, diçka që është shumë pozitive. I përmenda këto raste për dy arsye: E para për me ju dhanë shembuj se menaxherët e shkollave nuk duhej rreshtuar për të gjetur fonde për shkollat që i udhëheqin dhe e dyta për me i falënderuar donatoret dhe me ju bë thirrje bizneseve të tjera se përkrahja në fushën e arsimit është në interes të përgjithshëm të shoqërisë. Edhe pse raporti ka të bëj vetëm me periodën e parë, megjithatë nuk mund të kalojmë këtë pikë pa i përmend disa nga punët dhe aktivitete të mira, që janë bërë këta muajt e fundit. Bie fjala nga fillimi i muajit mars i këtij viti, ka filluar furnizimi i nxënësve me kifle, e nga ajo që i kemi pa, kiflet janë mjaftë kualitet. Duke e pasur parasysh që kryetari i komunës z. Ferit Idrizi vjen pikërisht nga fusha e arsimit, për pak muaj të qeverisjes ka marr një varg iniciativash, e që ndërlidhen pikërisht me fushën e arsimit. Javë me parë me iniciativën e kryetarit u formua grupi vlerësues i shtëpi-shkollave të viteve 1990-ta, grup të cilin e udhëhiqi, dhe për dijeninë tuaj, ky grup e ka vazhduar punën, kemi dal në teren, i kemi identifikua pjesën dërmuese dhe jemi duke e përgatitur një raport për kryetarin dhe kuvendin. Po ashtu me iniciativën e kryetarit, muaj me par kanë filluar përgatitjet për organizimin e kuizeve të diturisë në të gjitha nivelet. Është formuar grupi punues, është hartuar rregullorja e garave, janë përgatitur pyetjet dhe u janë shpërndarë nxënësve. Këto gara të diturisë prej disa vitesh i’u kanë munguar shkollave në Vushtrri. Dhe diçka që është shumë pozitive dhe lajm shumë i mirë, për çka e ka nda edhe kryetari këto ditë, është

vendimi i rritjes së numrit të bursave për studentë nga 50 në 70. Megjithatë, unë këtu e kam edhe një propozim që organet komunale të bashkëpunojnë edhe me bizneset dhe të gjejnë mundësi që edhe ata të kontribuojnë për rritjen e numrit të bursave për studentë. Një gjë të tillë e bëjnë edhe disa komuna tjera dhe nuk është e kundërligjshme. Jam i vetëdijshëm se këto veprime dhe shumë veprime tjera në muajt në vijim, do te ndikojë që sa do pak të rritej cilësia në arsim, por po ashtu jam shumë i vetëdijshëm se vetëm me masa në nivel komunal, është e pa mundur të kemi një arsim në nivelin e duhur. E në fund dua të theksojë që: Pa një arsim cilësor, nuk mund ti konkurrojmë shoqëritë e përparuara, e për një arsim cilësor ne si shoqëri duhej ta vemi arsimin si top-prioritet.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se i vjen mirë që propozimet e tij të shtruara në KPF, janë marr për bazë nga DKA në hartimin e kësaj informate. E ardhmja e fëmijëve tanë varet nga arsimi i tyre dhe të gjithë duhet angazhuar për ngritjen e avancimin e kësaj fushe. Ai vlerësoi se nuk duhet frikësuar debatit për arsim dhe njëkohësisht nuk duhet që atë ta politizojmë. Në emër të grupit kuvendar të LVV-së, e inkurajoj kryetarin e komunës që të ndërmarr hapa reformator në fushën e arsimit për përmirësimin e gjendje në këtë veprimtari shoqërore mjaft me peshë. Për tej dallimeve politike dhe ngjyrimeve tjera, arsimi duhet ti përbashkoj të gjithë për ta ngritur perfomrancën. Informata e ofruar nga drejtoria më tepër flet për statistika dhe çështjet e infrastrukturës se sa që merret me cilësinë në arsim. Në informatë nuk ka asnjë statistikë për masat disiplinore qoftë për mësimdhënësit apo për nxënësit, dhe në këtë rrjedh nuk dihet nëse dikush është penalizuar me ndonjë masë. Më pas nuk ka të dhëna për dhunën në shkolla edhe pse të gjithë e dimë se ka problem nëpër shkollat tona me huliganizëm dhe dhunë, ka problem me dukurit devijante si duhan pirja narkomania e të ngjashme. Para disa dite e kemi pa në media gjendjen e një mirëmbajtësi në shkollën e fshatit Smrekonicë dhe për këtë problematikë nuk kemi asnjë fjalë. Më tej në informatë nuk figuron shkolla regjionale e mjekësisë që ndodhet në Mitrovicë, e ku atje mësojnë një numër i konsiderueshëm i fëmijëve tanë. Nuk të dhëna për identifikimin e nxënësve që konsiderohen si super talent, e që është dashur që kjo e dhënë të evidentohet. Lidhur me garat sportive të nnxënsve dhe rezultatet e arritura, ceku se komuna duhet ti shpërble nxënësit që kanë arritur suksese me ndonjë çmim dhe kështu të kemi një stimulim të këtyre nxënësve. Në fund përsërit dhe inkurajoj kryetarin e komunës për fillimin e reformave në arsimin e komunës, duke pasur për bazë specifikat e komunës por edhe duke u bazuar në numrin e banorëve dhe numrin e nxënësve sepse ekziston rreziku që shkollat që janë me pak nxënës pasi disa viteve të mbyllen.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se informata në fjalë është vërtet e kompletuar, pasi që asnjëherë më parë nuk janë ofruar të dhëna për zhvillimet e gjithmbarshme në sferën e arsimit për çka edhe e përgëzon drejtorinë. Parafolësit edhe pse deklarojnë se nuk dëshirojnë të politizohet arsimi ata në të vërtet mbajë vetëm fjalime politike për të përfituar ndonjë poen politikë tek qytetaret dhe sillen sikur të ishim në fushatë elektorale. Ajo se çfarë ai ka pritur nga kolegët e tij parafolës është nëse ata kanë gjetur ndonjë modalitet për ngritjen e mësimdhënies dhe mësim nxënies dhe ngritjen e cilësisë në përgjithësi. Nga diskutimet e mëhershme nuk pamë diçka që e vlen përpos konstatimeve mbi gjendjen faktike dhe atë se mungon ndonjë presë apo ndonjë pikë në këtë dokument. Kemi problem me zvogëlimin e numrit të nxënësve në disa shkolla, dhe kjo dukuri do reflektoj në mësimdhënie dhe mësimnxënie, në këtë kontekst duhet gjetur një modalitet mes qeveris komunale dhe prindërve, por që në asnjë rrethanë nuk duhet mbyllur shkollat pa pëlqimin e prindërve. Në fund tha se në informatë është evidentuar se në një përqindje të vogël është një numër i nxënësve të pa notuar, dhe për këtë duhet shikohet sepse është obligim ligjor që në ciklin e ulët nxënësit të mos mbesin të pa notuar.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-**tha se drejtoresha e arsimit ka ofruar para kuvendit një informatë mjaft gjithëpërfshirëse me diagrame të cilën e përgëzon. Ajo çka është shqetësuese është faktin i rënies së numrit të nxënësve për të cilën duhet gjetur një zgjidhje.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**deklaroi se nga data 29.03.2022 zyrtarisht është bërë pjesë e subjektit politike Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, pra nga sot koalicionit PDK-AAK i shtohet edhe një asamblist. Tutje ai përgëzoi kryetarin e komunës dhe drejtoreshën e arsimit për prioritetin që po i japin arsimit ashtu sikur edhe ka premtuar kryetari Idrizi në fushatën zgjedhore. Problematika e rënies së suksesit duke u ngjitur në klas më të lartë apo duke u rritur është një problem i kahershëm dhe ka përmasa kombëtare, për të cilin duhet gjetur një zgjidhje. Më tej shtoi se kemi probleme sa i përket orientimit në karrierë sepse nxënësi duhet të përcaktohet qysh në klasën e gjatës se çfarë profesioni duhet të merr. Në fund ai përgëzoi drejtoreshën për punën e mirë që është duke bërë.
**Miradije Maloku, drejtoreshë e DKA-së-**paraqiti sqarime lidhur me informatën, duke u përgjigjur në temat dhe pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Në vazhdim ai paraqiti të dhëna dhe statistika sa i përket numrit të shkollave, numrit ë nxënësve dhe numrit të mësimdhënësve në Komunën e Vushtrrisë. Tutej konstatoi se kemi rëne të numrit të nnxënsve në cilin e ulët në viset rurale si: Dumnicë e Epërme, Ceceli, Pasomn Gllavatinë etj. Lidhur me problemin e rënies së suksesit nga cikli i ulët në shkollën e mesme, vlerësoi se ky krahasim nuk mund të bëhet pasi që dallon plan programi nga niveli i ultë në atë të mesëm. Lidhur me rastin që ka ndodhur në shkollën e fashit Smrekonicë, ku është helmuar një mirëmbajtësi i asaj shkolle ajo paraqiti para kuvendit raportin e konstatimit të atij rasti të cilën e lexoj para anëtarëve të kuvendit.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**vlerësoi se përmirësimi i infrastrukturës shkollore është kusht i nevojshëm për zhvillimin e arsimit por jo i domosdoshëm, andaj edhe propozoi që projektet për ndërtimin e shkollave të hiqen fare nga DKA-ja dhe të vendosen në Drejtorinë e Urbanizmit, ndërsa zyrtaret e DKA-së të merren ekskluzivisht me çështje të arsimit dhe cilësisë në arsim.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se ka vërejt dhe është evidente dhe e konstatuar se gjendje në arsim nuk është e mirë, dhe fajet duhet kërkuar por ato kryesisht vinë nga përpilimi i kurrikulave dhe mos përshtatja në sistemin tonë arsimor. Por qeveria komunale nuk është duke mbetur duarkryq, ajo ka filluar në pilotimin e garave të diturës në fusha dhe lëndë të ndryshme me qëllim të ngritjes së konkurrencës dhe mobilizimit, procesi ka filluar me klastë e V, IX dhe klastë e XII, madje sugjerimi i tij ka qenë që për klasët e XII, pyetjet të jenë nga testi pranues në fakultet të mjekësisë arkitekturës dhe ndërtimtarisë. Ajo se çfarë është synim i tij është shtrirja e bashkëpunimit mes kryetarit-qeverisë komunale, dhe kuvendit por edhe me drejtoret e shkollave, ashtu që të rritet përgjegjësia llogaridhënia dhe ngritja e cilësisë së arsimit. Rënia e numrit të nxënëseve nuk është domosdo kusht për rënien e rezultateve të arsimit, sepse më lehtë mund ti përgatitesh pesë nxënës në matematikë se sa 50 nxënës në një klasë, defekti është tek mbikëqyrja sepse në disa shkolla orët mbahen vetëm 15 minuta e jo 45 minuta ashtu si është e paraparë me normativ shkollor. Në fund tha se si kryetar i komunë do të bashkëpunoj ngush me Ministrinë e Arsimit, dhe nuk e ka ndër mend të dal jashtë përgjegjësve ligjore që i takojnë sikur se kishte ndodhur me një kryetar komuna që e kishte sfiduar veten me mbyllje shkollash, ndërsa ditëve në vijim do ta shpalos planin e zhvillimor të arsimit dhe aty janë paraparë mekanizmat për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe pretë që edhe anëtarët e kuvendit me eksperiencën e tyre të japin kontributin e tyre.

**5.** Shqyrtimi i Informatës lidhur me punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2021;

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se në këtë informatë thuhet se në mbledhjen e muajt shkurt dolën tri rekomandime ndërsa janë cekur vet[m dy prej tyre.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se në këtë informatë janë pasqyruar aktivitet e Këshillit për Siguri në Bashkësi, forum ky i cili ka një rëndësi të veçantë sepse nga funksionimi i tij dalin shumë rekomandime që ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sferave tjera komunale.

**6.** Shqyrtimi i Planit të punës i Këshillit për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se plani i punës i Këshillit për Siguri në Bashkësi për vitin 2022, është i ndarë në objektiva dhe brenda afateve mendohet të realizohen aktivitet e parapara.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoj Planin e punës të Këshillit për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.**

**7.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelat kadastrale P-70202017- 00107-0 me sipërfaqe prej 8766 $m^2$, me kulturë arë e klasës së pestë (5) dhe parcela kadastrale P–70202017-00109-0 me sipërfaqe prej 7342 $m^2$, me kulturë arë e klasës së pestë (5), Zona Kadastrale Gllavatin - Komuna e Vushtrrisë, që evidentohen në emër të N.P.T "ECOTECH" me pronar Suphi Metëhiu.

2. Qëllimi i lejimit, të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të parcelave kadastrale të cekura si në pikën 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit industrial për prodhimin e ngjyrave dhe llaqeve.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Obligohet pronari i parcelave nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore të klasës 5, sipas nenit 14, paragrafi 14.2, pika "b" të Udhëzimit Administrativ Nr.401/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të klasës 5, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për hartimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për hartimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale në përbërjen si në vijim:

1.1 Nurie Halili, anëtare e kuvendit (PDK);
1.2 Shkelzen Xhaferi, anëtar i kuvendit (LDK);
1.3 Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit (LVV);
1.4 Bekim Selmani, shef i Sektorit të gjendjes civile;
1.5 Merita Rama, zyrtare për buxhet dhe financa.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedh kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë dhe hartojë Rregulloren për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale, duke e marrë për bazë rregulloren bazë dhe plotësim-ndryshimet e bëra nëpër vite, në mënyrë që të hartohet një tekst i spastruar i rregullores në fjalë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**9.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në bujqësi;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr.03/2020 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, me nr. të protokollit 01.nr.45/20 i datës 27.2.2020, në këtë përbërje:

1.1.Mentor Hasani, anëtar i kuvendit (PDK);
1.2.Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);
1.3.Refik Maloku, anëtar i kuvendit (LVV);
1.4.Fatmir Feka, zyrtar ligjor në DEBPZHR dhe
1.5.Tefik Maloku, shef i Sektorit të bujqësisë.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë ndryshim-plotësimet e dispozitave të rregullores dhe të përgatitë draftin "Propozim-ndryshimet e rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**10.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës për lirim nga pagesa e taksës për shërbimet e çerdheve publike;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.29/22 i datës 31.1.2022 lidhur me lirimin nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve për fëmijët që marrin shërbime nga çerdhet publike.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**11.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me 16 vota "për" 7 vota "kundër" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim zgjatet afati kohor për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë, i përcaktuar me vendim fillestar (nr. 255/18 – 5) të marrë më 27/9/2018 nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

2. Afati shtesë për hartimin e Hartës Zonale të Komunës nga subjekti përgjegjës është 9 muaj (27/3/2022-27/12/2022), i cili i vazhdohet afatit të mëparshëm (27/9/2018 – 27/9/2020-27/3/2022).

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

12. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të komunës me numër të protokollit 01-54/22 i datës 24.02.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër në Komunën e Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim plotësohet dhe harmonizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01-54/22 i datës 24.2.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, në parcelën kadastrale P-70202016-00655-0, në sipërfaqe prej 1637 $m^2$, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, ashtu që ndryshimi i vendimit të cekur më lart konsiston në plotësimin dhe harmonizimin e preambulës së vendimit me referencat në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, konform instruksioneve ligjore të dhëna nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:25.**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ____________________ | ________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 07.04.2022 |
| **PËR/ZA/TO:** | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| **PËRMES** | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës |
| **NGA/OD/FROM:** | Abit Abiti, ZKF |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Raport tremujor, Janar – Mars 2022 |

Në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur raportin tremujor, i cili mbulon vitin fiskal e deri në fund të këtij tremujori që sapo ka përfunduar. Ky raport përmban shënime mbi arkëtimet, shpenzimet dhe një përmbledhje të shpenzimeve kapitale. Këtë raport e prezantojmë para KPF-Së dhe Kuvendit Komunal, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komunës.

Me respekt!

Shtojcë raportet:

| Emri i Komunës : | K.K.VUSHTRRI | |
|---|---|---|
| Kodi i Komunës: | 644 | |
| Periudha raportuese | Janar - Mars | 2022 |

## TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

| Përshkrimi | Kodi | Periudha raportuese | | | Vjetore | | | | Viti i kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Buxheti i planifikuar për PR | Të hyrat e realizuar në PR | Përqindja e buxhet të realizuar për PR | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2021 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| **Administrata dhe personeli** | **163** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Taksa administrative | | 17,500.00 | 17,469.00 | **100%** | 70,000.00 | **52,531.00** | 0.00 | **70,000.00** | 13,495.00 |
| **TOTAL** | | **17,500.00** | **17,469.00** | **100%** | **70,000.00** | **52,531.00** | **0.00** | **70,000.00** | **13,495.00** |
| | | | | | | | | | |
| **Inspeksioni** | **166** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Pranime teknike | | 1,250.00 | 1,245.00 | **100%** | 5,000.00 | **3,755.00** | 0.00 | **5,000.00** | 665.00 |
| Pelqimet sanitare | | 1,500.00 | | **0%** | 6,000.00 | **6,000.00** | 0.00 | **6,000.00** | 1,691.79 |
| Gjobat e inspeksionit | | 250.00 | 1,275.00 | **510%** | 1,000.00 | **-275.00** | 0.00 | **1,000.00** | 5,887.16 |
| **TOTAL** | | **3,000.00** | **2,520.00** | **84%** | **12,000.00** | **9,480.00** | **0.00** | **12,000.00** | **8,243.95** |
| | | | | | | | | | |
| **Buxhet dhe Financa** | **175** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Taksat e firmave | | 2,500.00 | 14,250.00 | **570%** | 10,000.00 | **-4,250.00** | 0.00 | **10,000.00** | 6,000.00 |
| Tatimi në pronë | | 264,917.25 | 200,854.34 | **76%** | 1,059,669.00 | **858,814.66** | 0.00 | **1,059,669.00** | 203,426.87 |
| **TOTAL** | | **267,417.25** | **215,104.34** | **80%** | **1,069,669.00** | **854,564.66** | **0.00** | **1,069,669.00** | **209,426.87** |
| | | | | | | | | | |
| **Arsimi** | **900** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| **Shitja e prodhimeve** | | | | | | | | | |
| Participimi në çerdhen e fëmijëve | | 11,250.00 | 11,643.00 | **103%** | 45,000.00 | **33,357.00** | 0.00 | **45,000.00** | 5,022.00 |
| Shkolla e Mesme Teknike | | 3,750.00 | 4,620.00 | **123%** | 15,000.00 | **10,380.00** | 0.00 | **15,000.00** | 3,220.00 |
| Shkolla e Mesme Profesionale | | 3,500.00 | 5,860.00 | **167%** | 14,000.00 | **8,140.00** | 0.00 | **14,000.00** | 6,946.00 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **TOTAL** | | **18,500.00** | **22,123.00** | **120%** | **74,000.00** | **51,877.00** | **0.00** | **74,000.00** | **15,188.00** |
| | | | | | | | | | |
| **Gjeodezi dhe Kadastër** | **650** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Qiraja nga objektet publike | | 5,750.00 | 2,155.00 | **37%** | 23,000.00 | **20,845.00** | 0.00 | **23,000.00** | 2,155.00 |
| Të hyrat nga Gjeodezia dhe Kadastri | | 10,000.00 | 30,467.00 | **305%** | 40,000.00 | **9,533.00** | 0.00 | **40,000.00** | 25,135.12 |
| **TOTAL** | | **15,750.00** | **32,622.00** | **207%** | **63,000.00** | **30,378.00** | **0.00** | **63,000.00** | **27,290.12** |
| | | | | | | | | | |
| **Kulturë, rini dhe sport** | **850** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Palestra e sportit | | 250.00 | 48.00 | **19%** | 1,000.00 | **952.00** | 0.00 | **1,000.00** | 300.00 |
| Biblioteka | | 125.00 | | **0%** | 500.00 | **500.00** | 0.00 | **500.00** | 46.00 |
| Shtëpia e Kulturës | | 250.00 | | **0%** | 1,000.00 | **1,000.00** | 0.00 | **1,000.00** | 265.00 |
| **TOTAL** | | **625.00** | **48.00** | **8%** | **2,500.00** | **2,452.00** | **0.00** | **2,500.00** | **611.00** |
| | | | | | | | | | |
| **Shërbime publike** | **180** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Parkingjet | | 500.00 | 880.00 | **176%** | 2,000.00 | **1,120.00** | 0.00 | **2,000.00** | 380.00 |
| Regjistrimi I automjeteve | | 20,750.00 | 30,250.50 | **146%** | 83,000.00 | **52,749.50** | 0.00 | **83,000.00** | 27,920.00 |
| Taksat e mbeturinave | | 153,433.50 | 130,668.49 | **85%** | 613,734.00 | **483,065.51** | 0.00 | **613,734.00** | 118,592.65 |
| **TOTAL** | | **174,683.50** | **161,798.99** | **93%** | **698,734.00** | **536,935.01** | **0.00** | **698,734.00** | **146,892.65** |
| | | | | | | | | | |
| **Bujqësi** | **470** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Ndryshimi i destinimit të tokës | | 2,500.00 | 3,637.00 | **145%** | 10,000.00 | **6,363.00** | 0.00 | **10,000.00** | 14,341.69 |
| Leje pune | | | 50.00 | | | | | | |
| **TOTAL** | | **2,500.00** | **3,687.00** | **147%** | **10,000.00** | **6,363.00** | **0.00** | **10,000.00** | **14,341.69** |
| | | | | | | | | | |
| **Shëndetësi** | **700** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Participim | | 12,500.00 | 11,227.50 | **90%** | 50,000.00 | **38,772.50** | 0.00 | **50,000.00** | 11,566.50 |
| Paricipim QPS | | 500.00 | 830.00 | **166%** | 2,000.00 | **1,170.00** | 0.00 | **2,000.00** | 821.00 |
| **TOTAL** | | **13,000.00** | **12,057.50** | **93%** | **52,000.00** | **39,942.50** | **0.00** | **52,000.00** | **12,387.50** |
| | | | | | | | | | |
| **Urbanizmi** | **660** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |
| Lejet e ndërtimit | | 51,473.00 | 181,457.20 | **353%** | 205,892.00 | **24,434.80** | 0.00 | **205,892.00** | 94,922.22 |
| leje mjedisore | | | 14,897.28 | | | | | | |
| Legalizim I Objekteve | | | 491.61 | | | | | | |
| Rrenim I objekteve | | | | | | | | | |
| Shfrytëzimi i pronës Publike | | 1,250.00 | 3,984.20 | **319%** | 5,000.00 | **1,015.80** | 0.00 | **5,000.00** | 10.00 |
| **TOTAL** | | **52,723.00** | **200,830.29** | **381%** | **210,892.00** | **25,450.60** | **0.00** | **210,892.00** | **94,932.22** |
| | | | | | | | | | |
| | **850** | **€** | **€** | **%** | **€** | **€** | **€** | **€** | **€** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjobat e trafikut | | | **0%** | | | 0.00 | **0.00** | |
| Gjobat e gjykatave | | | **0%** | | | 0.00 | **0.00** | |
| Gjobat e pyjeve | | 50.00 | | | | | | |
| Të hyrat tjera | | 20,973.00 | **#VALUE!** | | **-20,973.00** | 0.00 | **0.00** | 7,035.73 |
| **TOTAL** | **0.00** | **21,023.00** | **#DIV/0!** | **0.00** | **-20,973.00** | **0.00** | **0.00** | **7,035.73** |
| | | | | | | | | |
| | **565,698.75** | **689,283.12** | **122%** | **2,262,795.00** | **1,573,511.88** | **0.00** | **2,262,795.00** | **549,844.73** |

#REF! K.K.Vushtrri

#REF! 644

Periudha raportuese Janar - Mars

## PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

*Ndërtimi I rrjetit të ujësjellësit me rezervuar për fshtrat Pasomë - Dunice Epërme*

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar 2022 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Finacimi nga huamarrjet | 04 | | | 0% | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | |
| Granti Qeveritar | 10 | 3,283,252.20 | 2,928,068.13 | 89% | 21,693,771.21 | 18,765,703.08 | 0.00 | 21,693,771.21 | 3,467,721.43 |
| Të hyrat vetanake | 21 | | | 0% | 2,262,795.00 | 2,262,795.00 | 0.00 | 2,262,795.00 | 77,744.46 |
| Mjetet e bartura | 22 | | | 0% | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | |
| Donacionet e brendshme | 31 | 52,001.23 | | 0% | 52,001.23 | 52,001.23 | 0.00 | 52,001.23 | |
| Donacionet e jashtme | 32 | 40,557.54 | 20,825.39 | 51% | 40,557.54 | 19,732.15 | 0.00 | 40,557.54 | |
| TOTALI | | 3,375,810.97 | 2,948,893.52 | 87% | 24,049,124.98 | 21,100,231.46 | 0.00 | 24,049,124.98 | 3,545,465.89 |

Për shkak të mos miratimit të buxhetit sipas Nenit 20.3 të LMFPP, Konunës së Vushtrrisë ju kanë alokuar për shpenzime 3/12 e buxhetit të vitit 2021

| | |
|---|---|
| Komuna | VUSHTRRI |
| Kodi | 644 |
| Periudha raportuese | Janar - Mars |

## PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE

| PËRSHKRIMI | KODI | PERIUDHA RAPORTUESE | | | VJETORE | | | | Viti I kaluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | BUXHETI I PLANIFIIKUAR | Shpenzimet të realizuar në PR | Përqindja e nuxhetit të alokuar | Buxheti I planifikuar për 2022 | Buxheti I mbetur për 2022 | Plani I reviduar 2022 | Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar | Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2021 |
| | | 4 | 5 | 6 = 5/4*100 | 7 | 8= 7-5 | 9 | 10 = 7-9 | 11 |
| | | € | € | % | € | € | € | € | € |
| Paga dhe mëditje | 111 | 2,567,377.53 | 2,471,085.80 | 96% | 10,720,000.00 | 8,248,914.20 | 0.00 | 10,720,000.00 | 2,682,964.43 |
| Mallra dhe shërbime | 130 | 568,524.07 | 356,942.78 | 63% | 3,278,238.00 | 2,921,295.22 | 0.00 | 3,278,238.00 | 579,097.25 |
| Shpenzimet komunale | 132 | 68,508.75 | 62,257.94 | 91% | 428,000.00 | 365,742.06 | 0.00 | 428,000.00 | 76,171.33 |
| Subvencionet dhe transferet | 200 | 93,866.67 | 37,900.00 | 40% | 657,540.00 | 619,640.00 | 0.00 | 657,540.00 | 40,760.00 |
| Investimet kapitale | 300 | 77,533.95 | 20,707.00 | 27% | 4,779,107.00 | 4,758,400.00 | 0.00 | 4,779,107.00 | 166,472.88 |
| TOTALI | | 3,375,810.97 | 2,948,893.52 | 87% | 19,862,885.00 | 16,913,991.48 | 0.00 | 19,862,885.00 | 3,545,465.89 |

Në Kategorinë e investimeve kapitale kemi pasur vetëm një shpenzim nga donacionet e jashtme për projektin "Një ecje në histori"

#REF! VUSHTRRI

Kodi I komunës: 644

Periudha raportuese Janar - Mars 2022

| KODI | Mallrat dhe shërbimet | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|
| 13130 | Shpenzimet e udhetimit zyrtar brenda vendit | 1,076.45 | |
| 13132 | Akomodimi I udhetimit zyrtar brenda vendit | 768.00 | |
| 13133 | Shpenzimet e tjera të-udhetimit zyrtar brenda vendit | 10.76 | 216.24 |
| 13140 | Shpenzimet e udhetimit zyrtar jasht vendit | 700.00 | |
| 13141 | Shpenzimet të vogla -para xhepi | 1,612.00 | 309.00 |
| 13142 | Akomodimet e udhetimit zyrtar jasht vendit | 810.00 | |
| 13143 | Shpenzimet tjera e udhetimit zyrtar jasht vendit | 351.00 | 39.00 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | 2,936.07 | 1,818.25 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 25,527.24 | 1,599.42 |
| 13330 | Shpenzimet postare | 12,936.53 | 233.30 |
| 13410 | Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit | | |
| 13420 | Sherbimet e perfaqsimit - avokaturë | 94.40 | |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | 6,351.54 | 150.00 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 32.00 | 36.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje - jo marketing | | |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 1,831,096.21 | 242,260.28 |
| 13470 | Shërbime teknike | 1,867.17 | 400.00 |
| 13780 | Shpenzimet për antarsim | 17,480.50 | |
| 13490 | Shërbimet e varrimit | 107,460.00 | |
| 13501 | Mobilje (më pak se 1000 euro) | 17,402.40 | 493.00 |
| 13503 | Kompjuter (më pak se 1000 euro) | 93,234.10 | |
| 13504 | Harduer për teknikë informative (më pak se 1000 euro) | 332.36 | |
| 13508 | paisje trafiku (më pak se 1000 euro) | 363.00 | |
| 13509 | paisje tjera (më pak se 1000 euro) | 63,660.57 | 11,241.00 |
| 13506 | Pajisje specialistike mjeksore | | |
| 13509 | Pajisje tjera (me pak se 1000 euro) | | |
| 13510 | blerja e librave edhe veprave artistike | 2,399.00 | |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 93,541.68 | 9,271.68 |
| 13611 | Furnizim me dokumenta bllanko | 5,600.00 | |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 29,985.35 | 2,270.82 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | 109,423.41 | 2,990.50 |
| 13640 | Furnizime pastrimi | 23,663.01 | 514.50 |
| 13650 | Furnizim me veshmbathje | 13,306.00 | |
| 13655 | Furnizim me preparate kimike | 2,071.50 | 991.00 |
| 13710 | vaj | 726.00 | 303.00 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | 56,099.41 | 18,006.16 |
| 13730 | Vaj per ngrohje qendrore | | |
| 13760 | Dru | 190,589.24 | 31,754.00 |
| 13770 | Derivate per gjenerator | 2,202.06 | 1,601.26 |
| 13780 | Karburant per vetura | 42,091.28 | 6,587.62 |
| 13790 | Gas natyror | 198.65 | |
| 13810 | Avanc për para të imta | 4,000.00 | 1,800.00 |
| 13820 | Avanc për udhëtime zyrtare | 2,118.53 | 3,139.00 |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

| | |
|---|---|
| **DATË:** | **07.04.222** |
| **PËR:** | **Kuvendin e Komunës** |
| **PROPOZUES:** | **Ferit Idrizi**<br>**Kryetar i Komunës së Vushtrrisë**________ |
| **HARTUES:** | **Drejtoria për Administratë**<br>**Drejtori i Drejtorisë: znj. Hava Mlinaku**________ |
| **TEMA:** | **Akt – përcjellës** |

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur draft –rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë , raportin nga konsultimet publike me qytetarë dhe të gjitha email adresat me komente dërguar nga qytetar të komunës sonë.

Me respekt!

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republik of Kosovo
**Komuna Vushtrri**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28/2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 41, paragrafi 41.2, pika **c** e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _________2022, miratoi këtë:

# DRAFT
# RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

## Neni 1
## Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në themelimin e këshillave lokale, në ushtrimin e aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.

## Neni 2
## Fushëveprimi

Kjo rregullore përcakton themelimin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, duke formuar këshilla lokale, si trupa mbështetës të komunës dhe që të ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

## Neni 3
## Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në vijim:

1.1 **Këshillat lokale** – nënkupton trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

1.2 **Kryetar i këshillit** – nënkupton personin me të votuar në tubim zgjedhor në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

**Neni 4**
**Formimi i këshillave lokale**

Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Komuna e Vushtrrisë do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokale. Një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivele të këshillave lokale dhe janë parashikuar në nenin **6** të kësaj rregulloreje.

**Neni 5**
**Komisioni për përzgjedhjen e këshillave lokale**

1. Kuvendi i komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Ky përfaqësues zgjedhet ad-hoc nga komisioni.
2. Komisioni duhet të reflektojë përfaqësim gjinor dhe etnik. Nga shtatë (7) anëtarët e komisionit, përfaqësimi gjinor do të jetë tre (3) me katër (4) të gjinive të kundërta.
3. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të komunës.
4. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës.
5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetar të këshillave lokale.
6. Së paku pesë (5) anëtarë të komisionit, prej të cilëve së paku dy (2) përfaqësues nga Kuvendi i komunës, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.
7. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
8. Komisioni i raporton Kuvendit të komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.

**Neni 6**
**Këshillat lokale në Komunën e Vushtrrisë**

**6.1** Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019, neni 4, paragrafi 2, në territorin e Komunës së Vushtrrisë themelohen këta këshilla lokale si më poshtë:
6.1.1 Këshilli lokal Kalaja I;
6.1.2 Këshilli lokal Kalaja II;
6.1.3 Këshilli lokal Dardania I;
6.1.4 Këshilli lokal Dardania II;

6.1.5. Këshilli lokal Karaçë: Karaçë, Miraçë, Shlivovicë, Gumnishtë, Skromë, Boshlan, Kurilovë dhe Vesekoc;
6.1.6. Këshilli lokal Begaj: Begaj dhe Gojbulë;
6.1.7. Këshilli lokal Studime e Poshtme: Studime e Poshtme, Studime e Epërme, dhe Skoçan;
6.1.8. Këshilli lokal Nedakoc;, Nedakoc, Pestovë, Mavriq, Svaraçak i Poshtëm, dhe Svaraçak i Epërm
6.1.9. Këshilli lokal Maxhunaj: Maxhunaj, Ropicë, dhe Vilanc;
6.1.10. Këshilli lokal Samadrexhë: Samadrexhë, Ceceli, Sllakoc, Kunovik dhe Zagorë;
6.1.11. Këshilli lokal Dumnicë e Poshtme: Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Llugës dhe Dumnicë e Epërme;
6.1.12. Këshilli lokal Stanoc i Epërm: Stanoc i Epërm dhe Gracë;
6.1.13. Këshilli lokal Stanoc i Poshtëm: Stanoc i Poshtëm dhe Lumadh;
6.1.14. Këshilli lokal Prelluzhë; Prelluzhë
6.1.15. Këshilli lokal Stroc: Stroc, Bivolak, Zhilivodë, Gllavatin dhe Beçuk
6.1.16. Këshilli lokal Druar: Druar, Mihaliq Reznik, dhe Shalë
6.1.17. Këshilli lokal Novolan: Novolan, Brusnik Kollë, dheVerrnic ;
6.1.18. Këshilli lokal Duboc: Duboc, Beçiq,Taraxhë dhe Galicë;
6.1.19. Këshilli lokal Akrashtic: Akrashtic, Jezerë, dhe Balincë;
6.1.20. Këshilli lokal Bukosh: Bukosh, Dalak dhe Shtitaricë;
6.1.21. Këshilli lokal Pantinë: Pantinë, Oshlan dhe Hercegovë;
6.1.22. Këshilli lokal Smrekonicë: Dobërllukë; Smrekonicë, Banjskë, Sllatinë, Pasomë dhe Tërllobuq.

**6.2** Kufijtë territorial të lagjeve urbane përcaktohen nga Komisioni i Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me lokalitetin.

## Neni 7
## Njoftimi për organizimin e takimeve për përzgjedhjen e këshillave lokale

1. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë, për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
   1.1.Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe hapësirat më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen takimet për zgjedhjen e këshillave lokale;
   1.2. Mediave lokale;
   1.3. Ueb-faqes zyrtare të komunës;
   1.4. Platforma tjera të komunikimit.
2. Njoftimi për publikun duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit.

## Neni 8
## Përbërja e këshillave lokale

1. Këshilli lokal mund të ketë nga pesë (5) deri nëntë (9) anëtarë. Numri i anëtarëve për secilin këshill lokal, përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në takimin zgjedhor.
2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal me se paku 1 (një) anëtar Në raste kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, atëherë fshati apo lagja urbane me numër me të madh të banorëve, përfaqësohet me 1 (një) anëtar më shumë se fshatrat tjerë të këshillit lokal.
3. Anëtarë të këshillave lokale zgjedhen kandidatët, të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve me të drejtë vote të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në takim zgjedhor.
4. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të qytetarëve që marrin pjesë në takim.
5. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.
6. Nënkryetari i këshillit zgjidhet nga kryesia e këshillit në takimin e parë të radhës pas themelimit të këshillit lokal. Për mënyrën e votimit të zgjedhjes së nënkryetarit vendos kryesia e këshillit lokal.
7. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publik në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe platformat tjera të komunikimit menjëherë pas takimit zgjedhor.
8. Procesverbali i hartuar nga takimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në takim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje tjera të adresuara në takim.
9. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi i takimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi.

## Neni 9
## Kriteret e përzgjedhjes për këshillat lokale

1. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.
2. Kandidatët për anëtarë dhe kryetarë të këshillave lokale nuk mund të jenë kandidatë nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike.
3. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të propozojë së paku dy kandidatë për përfaqësim në këshillin lokal.
4. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 30 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, duke respektuar kuotën gjinore prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, dhe përfaqësimin etnik në lokalitete ku ka banorë të komuniteteve joshumicë.

5. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore sipas nenit **9**, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
6. Në këshillin lokal përfaqësohet edhe komuniteti joshumicë me numër më të madh të banorëve të atij lokaliteti, të cilët janë të pranishëm në takim dhe votojnë.
7. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në takimin e qytetarëve.

**Neni 10**
**Komisioni i ankesave**

1. Kuvendi i komunës themelon komisionin e ankesave i cili i shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.
2. Komisioni i ankesave do të ketë 3 anëtarë, të cilët zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës.
3. Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor.
4. Ankesat për parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten tek komisioni për ankesa brenda 3 ditëve të punës.
5. Komisioni i ankesave është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të ankesës t'ju kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.
6. Vendimet e komisionit të ankesave janë përfundimtare në procedurën administrative dhe të obligueshme për palët.
7. Komisioni i ankesave i raporton Kuvendit të komunës.

**Neni 11**
**Mandati i këshillave lokale**

1. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vjet.
2. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon si në vijim:
   2.1 me përfundimin e mandatit;
   2.2 nëse jep dorëheqje;
   2.3 nëse shkarkohet;
   2.4 nëse ndërron vendbanimin;
   2.5 në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër;
   2.6 Nëse vdes.
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.
4. Inicimi i procedurës për shkarkimin e kryetarit të këshillit bëhet me shumicën e anëtarëve të këshillit lokal dhe me peticion të nënshkruar më së paku prej 30 qytetarëve të atij lokaliteti.

5. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit lokal, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditë kalendarike duhet të organizojë zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
6. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes, me aprovimin e komisionit të kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.

**Neni 12**
**Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale**

1. Kryetari i komunës në bashkëpunim me kryesuesin e kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me kryetarët e këshillave lokale.
2. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike me qytetarë.
3. Kuvendi i komunës duhet të bëjë konsultime me këshillin lokal, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

**Neni 13**
**Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokale**

1. Me kërkesë të këshillit lokal dhe rekomandim të Kryetarit të komunës, apo ndonjë komiteti të kuvendit, Kuvendi i komunës me vendim të veçantë mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë kompetencë ekskluzive, vetanake të komunës.
2. Këshilli lokal duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna.
3. Bartja e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal duhet të mbështetet me financim dhe burime tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sipas përgjegjësive të bartura.

**Neni 14**
**Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit lokal**

1. Këshilli lokal mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet me interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Në mënyrë që kërkesat e qytetarëve të përcjellën rregullisht tek organet kompetente në komunë, këshilli lokal obligohet që të organizojë së paku një takim me qytetarë brenda një viti dhe sipas nevojës. Numri i takimeve të këshillit lokal sqarohet më tej në nenin **17**, paragrafin **5** të kësaj rregulloreje.
3. Këshilli lokal duhet të organizojë, hartojë dhe përcjellë prioritetet dhe kërkesat e lokalitetit te Kryetari, Kuvendi i komunës dhe drejtoritë komunale.

4. Këshilli lokal duhet të informojë komunën për kohën, vendin dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët kompetent komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
5. Takimet e qytetarëve organizohen me iniciativën e këshillit lokal.
6. Këshilli lokal mund të ndërmarrë këto aktivitete, të cilat në veçanti ndikojnë në:
   6.1 Planifikimin urban dhe rural;
   6.2 Furnizimin me ujë;
   6.3 Rregullimin e kanalizimit, drenazhimi;
   6.4 Rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda këshillit lokal;
   6.5 Shëndetësinë publike;
   6.6 Mbrojtjen lokale të ambientit;
   6.7 Turizmin;
   6.8 Hapësirat publike dhe varrezat;
   6.9 Aktivitetet kulturore, arsimore dhe sportive;
   6.10 Aktivitetet vullnetare në interes për këshillin lokal;
   6.11 Mirëqenien e banorëve të këshillit lokal – sigurimi i të dhënave për çdo familje, duke përcjellë gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime për mbështetje të këtyre rasteve.
   6.12 Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizatat tjera të shoqërisë civile – organizata joqeveritare, shoqata, klube etj., për çështje me interes për lokalitetin.
   6.13 Zbatimin e aktiviteteve që janë bartur, sipas procedurave të nenit 11 të kësaj rregulloreje.
7. Me pëlqimin e Kryetarit të komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve për monitorimin, zbatimin e projekteve për investime kapitale në lokalitetin e tyre.
8. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
9. Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë me shkrim, qoftë fizikisht apo përmes postës elektronike zyrtare, organeve kompetente të komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, dhe komuna i përgjigjet brenda afatit prej 30 ditësh.
10. Ne raste emergjente. Këshilli lokal shndërrohet në nënshtab emergjent.

**Neni 15**
**Roli i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal ka obligim t'i informojë anëtarët e këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet me organet e komunës.

3. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit.
4. Kryetari i këshillit lokal nënshkruan konkluzionet, propozimet dhe kërkesat e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre t'i adresojë në zyrën e Kryetarit të komunës.

**Neni 16**
**Financimi i aktiviteteve**

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale, mund të financohen si vijon:
   1.1 Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
   1.2 Nga komuna;
   1.3 Nga donatorët;
   1.4 Me financim të përbashkët.

**Neni 17**
**Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës me vendim të veçantë nga Kuvendi i komunës.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative të komunës.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.
4. Kompensimi bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit sipas nenit 13, paragrafi 4 të kës aj rregulloreje.
5. Numri i mbledhjeve me kompensim është gjashtë (6), ndërsa pa kompensim mund të mbahen edhe me shumë.

**Neni 18**
**Mos përmbushja e përgjegjësive**

Këshilli lokal mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga organet e komunës në këshillin lokal.

**Neni 19**
**Dispozitat kalimtare**

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e ligjit, udhëzimit administrativ apo statutit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr.03/16 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillave Lokale e Komunës së Vushtrrisë e datës 28.7.2016.

**Neni 20**
**Përgjegjësia për zbatim**

20.1 Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Administratë.

20.2 Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 21**
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe ueb-faqen e komunës.

**Kryesuesja e Kuvendit**

**Melihate Basholli Latifi**

## Fatmir Feka

**From:** agron hetemi <agron_hetemi@hotmail.com>
**Sent:** Tuesday, March 22, 2022 1:42 PM
**To:** Fatmir Feka; Bekim Selmani; Remzije Zekolli
**Subject:** Re: Kërkesë

Respekt per punen tuaj!

---

**From:** Fatmir Feka <fatmir.feka@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, March 22, 2022 9:31 AM
**To:** agron hetemi <agron_hetemi@hotmail.com>; Bekim Selmani <bekim.selmani@rks-gov.net>; Remzije Zekolli <remzije.zekolli@rks-gov.net>
**Subject:** RE: Kërkesë

Përshëndetje i nderuar, me poshtë i ke komentet te cila i ke dhen gjat takimit te se shtunës. Një raport përmbledhës nga konsultimet publike do te publikohet pas mbylljes se afatit për mbledhjen e komenteve sipas UA për standardet minimale te konsultimit publik ne komuna.
Duke ju falënderuar për kontributin e dhënë ne takimin e datës 19.03.2022, presim nga ju qe për çdo vërejtje sugjerim apo koment te mos hezitoni te na shkruani ne adresat elektronike.
Paraprakisht ju falënderojmë për mirëkuptim e bashkëpunim

Agron Hetemi - Lumadh

1. Këshilli Lokal për Stanoc i Poshtëm - nuk është e drejtë që numri i anëtarëve të kryesisë me i taku më shumë fshatit me numër më të madh të banorëve, për shkak se bëhet pabarazi në kryesi
2. 30% e popullsisë të fshatit për kuorum, jo 30 pjesëmarrës. Votimi të bëhet me shumicë të thjeshtë.
3. Fshatrat me u grupua sipas numrit të banorëve - Lumadhi mos me qene me Stanoc të Poshtëm - me qenë ose vet, ose me fshat me numër të njëjte të banorëve
4. Të gjendet modaliteti i cili lejon që anëtarë në komision për zgjedhjen e Këshillit të fshatit të jenë nga një përfaqësues, jo formal, nga secili fshat i Këshillit.

*Me respekt*
*Fatmir Feka, Zyrtar Ligjor në DEBPZHR*
**Komuna Vushtrri**

**Adresa: Rruga "Isa Boletini" Nr.44, 42000 Vushtrri, Republika e Kosovës**
**Mobil: + 383 44 215 343**
*tel. 03820042443*
*e-mail fatmir.feka@rks-gov.net*

---

**From:** agron hetemi <agron_hetemi@hotmail.com>
**Sent:** Monday, March 21, 2022 7:18 PM
**To:** Fatmir Feka <fatmir.feka@rks-gov.net>; Bekim Selmani <bekim.selmani@rks-gov.net>; Remzije Zekolli <remzije.zekolli@rks-gov.net>
**Subject:** Kërkesë
**Importance:** High

Përshendetje të nderuar, shpresoj që jeni mirë me shëndet.

Para se t'i dërgoj propozimet lidhur me Draft-Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, ju lutem më dërgoni procesverbalin e datës 19.03.2022, ku është mbajtur dëgjimi publik lidhur me rregulloren e lartëcekur në Shkollën Fillore "Migjeni" në fsh Stanofc i Epërm.

Me respekt, Agron Hetemi.

**Fatmir Feka**

**From:** Debora Peci <debora@dplus-ks.org>
**Sent:** Wednesday, April 6, 2022 12:10 PM
**To:** Fatmir Feka; Bekim Selmani; Remzije Zekolli
**Cc:** Hava Mlinaku; Valmir Ismaili
**Subject:** Re: Njoftim per takim

Pershendetje te gjitheve,
A i keni pranuar komentet nga ana ime? Gjithashtu, kur te takoheni ne grupin punues me tregoni cili ka qene verdikti per keto komente :)
Une javen tjeter do te jem ne Kosove, keshtu qe mundemi me u koordinu per hartim te raportit te konsultimit publik.

-Debora

**Debora Peci**
**PROJECT MANAGER**

+383 49 413 764 | www.dplus.org

Rruga "Tirana", Blloku C/4/1, Hyrja C,
Kati VIII, Nr. 83/84, 10 000, Prishtinë, Kosovë

---

**From:** Debora Peci <debora@dplus-ks.org>
**Sent:** Tuesday, April 5, 2022 8:43 AM
**To:** Fatmir Feka <fatmir.feka@rks-gov.net>; Bekim Selmani <bekim.selmani@rks-gov.net>; Remzije Zekolli <remzije.zekolli@rks-gov.net>
**Cc:** Hava Mlinaku <hava.mlinaku@rks-gov.net>; Valmir Ismaili <valmir@dplus-ks.org>
**Subject:** Re: Njoftim per takim

Pershendetje Fatmir dhe grupi punues,
Ju faleminderit shume per email, dhe kerkoj falje per vonese ne pergjigje.
Une do te jem jashte vendit deri te enjte (Te premten kthehem). Meqe afati eshte deri te premten, une mundem me i percjelle vetem komentet e mia per disa komente qe po me kujtohen, dhe nese ju pajtoheni mundemi me i inkoroporu ne rregullore:

1. **Numri i anetareve te fshatrave ne kryesi te keshillit**
   a. NENI 7, PARAGRAFI 2: Formulimi i tanishëm i këtij paragrafi nuk ka kuptim matematikor. Paragrafi thotë që "fshati, vendbanimi apo lagjja urbane me numër më të madh të banorëve, përfaqësohet me dy anëtarë në këshillin lokal." Nëse Këshilli i ka 5, 7 apo 9 anëtarë, dhe i ka 2 fshatra, kjo fjali nuk i rregullon si duhet anëtarët e kryesisë. Unë mendoj që formulimi i fjalisë duhet të jetë i këtillë:

*Çdo fshat, vendbanim, apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal me së paku 1 (një) anëtar. Në raste kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, atëherë fshati, vendbanimi apo lagjja urbane me numër më të madh të banorëve, përfaqësohet me 1 (një) anëtarë më shumë se fshatrat tjerë të këshillit lokal.*

Shembull: Nëse këshilli i ka 4 fshatra, të gjithë fshatrat fillimisht do të kenë nga 2 anëtarë, kurse fshatit më të madh i shtohet edhe një anëtarë tjetër = (2x4)+1 = 9.

2. **NENI: MANDATI I KËSHILLAVE LOAKLE** të shtohet ky nën-paragraf:

   2. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.

3. 2.1 Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe/ose anëtarëve të këshillave lokale iniciohet nga banorët e lokalitetit te Komisioni për Zgjedhjen e Këshillave Lokale. Inicimi i procedurës së shkarkimit të kryetarit dhe/ose anëtarëve të këshillave lokale bëhet me peticion, si dhe dëshmi që kryetari dhe/ose anëtarët e këshillave lokale kanë shkelur detyrat dhe përgjegjësitë e rregulluara me nenin 12 të kësaj rregulloreje.

Nese ju duhem dicka, mundemi me me kontaktu ne viber dhe i diskutojme sugjerimet nese keni ndonje pyetje.

Pune te mbare,

**Debora Peci**
**PROJECT MANAGER**

+383 49 413 764 | www.dplus.org

Rruga "Tirana", Blloku C/4/1, Hyrja C,
Kati VIII, Nr. 83/84, 10 000, Prishtinë, Kosovë

---

**From:** Fatmir Feka <fatmir.feka@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, April 5, 2022 8:13 AM
**To:** Debora Peci <debora@dplus-ks.org>; Bekim Selmani <bekim.selmani@rks-gov.net>; Remzije Zekolli <remzije.zekolli@rks-gov.net>
**Cc:** Hava Mlinaku <hava.mlinaku@rks-gov.net>
**Subject:** Njoftim per takim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në bazë të vendimit nr. **189/17** datë **29.06.2017** mbi mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e riteve fetare të varrimit si dhe shërbimet përcjellëse të varrimit, autorizon dhe i jep në përgjegjësi Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri kryerjen e shërbimeve të varrimit në tërë territorin e komunës së Vushtrrisë.

## Neni 2.

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri obligohet që të kryejë ritet e varrimit si:

- Hapjen e varrit,
- Dërrasat
- Qefinin,
- Piramidat me mbishkrim,
- Transportin e kufomës,
- Pastrimin e kufomës, dhe
- Kryerjen e ritualeve të varrimit sipas traditave fetare.

Shpenzimet për të gjitha këto rite fetare do të përmblidhen në një faturë që Bashkësia Islame do të përgatitë për Komunën, duke përfshirë emrin e personit që ka vdekur si dhe shërbimet që i ka kryer Bashkësia Islame (Hapja e varrit sipas parimeve fetare

islame pa arkivol; Transporti i kufomës brenda territorit të Vushtrrisë (nga shtëpia deri në xhami dhe prej aty në varreza dhe nga spitali (QKUK) në Prishtinë dhe aeroporti ndërkombëtar 'Adem Jashari; transporti i punëtorëve dhe mjeteve të punës; dezinfektimi i veturës; Dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr; Qefini përfshirë këtu edhe dorëzat higjienike, sapunin dhe pambukun; Piramida (dërrasa me mbishkrimin e të dhënave për të vdekurin); Pastrimi i kufomës nga personi i autorizuar; Shërbimi i imamit (kryerja komplet e ceremonisë mortore).
Shuma e faturës për ritet fetare të varrimit të cekura si më lartë është 210 € për një (1) person. Për çdo person do të përgatitet faturë e veçantë.
Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 189/17 datë 29.06.2017, shpenzimet do të mbulohen nga data 01.01.2018.

**Neni 3.**

1. Komuna e Vushtrrisë obligohet që për ritet dhe shërbimet e varrimit të paguajë shumën e specifikuar në Nenin 2 e dhe e cila i dërgohet Komunës në fillim të çdo muaji për muajin paraprak më së largu deri më datë 05 të muajit vijues.

1.1. Pagesa e shpenzimeve të shërbimeve duhet të bëhet nga data 01 deri 05 të muajit vijues në xhirollogarinë bankare të KBI-VUSHTRRI: NLB BANKA VUSHTRRI, KBI VUSHTRRI I BASHKESIS ISLAME 1707-0010-112350.02.

**Neni 4.**

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri obligohet që në fund të çdo muaji t'i raportojë Komunës së Vushtrrisë për rastet e vdekjeve si dhe të bëjë faturimin me kohë të faturave për pagesën e shërbimeve: faturën, evidencën e personave të vdekur dhe certifikatat nga libri amzë i të vdekurve.

**Neni 5.**

Memorandumi i Mirëkuptimit nuk e mbulon pagesa e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame.

**Neni 6.**

Për shërbime shtesë që kërkohen nga qytetarët dhe të cilat nuk janë të parapara në këtë memorandum, ata obligohen t'i bartin individualisht shpenzimet.

**Neni 7.**

Memorandumi i Mirëkuptimit është i lidhur për afatin kohor një vjeçar me mundësi të vazhdimit dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

**Neni 8.**

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të shkëputet njëanshëm nga ana e Komunës së Vushtrrisë me njoftim paraprak me shkrim në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh në rast se Këshilli i Bashkësisë islame nuk i respekton kriteret e respektuara në këtë memorandum apo në raste specifike dhe të arsyeshme.

**Neni 9.**

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh apo lidhet me këtë memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve kontraktuese. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim do të hapet kontest pranë Gjykatës kompetente.

**Neni 10.**

Çdo ndryshim i këtij memorandumi miratohet me shkrim nga palët kontraktuese.

**Neni 11.**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në katër (4) ekzemplarë dhe do të ju dorëzohen nga dy kopje palëve.

Palët-nënshkrimi-vula

Vushtrri, dt. 25 - 01.2018

Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Shemsi Rrahimi
Kryetar i BI-së Vushtrri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. 59/20
Nr. i fq. / Br. st -03-
Data: / Datum 24. 01. 2020
VUSHTRRI - VUČITRN

Komuna Vushtrri

Këshilli i Bashkësisë Islame
Vushtrri

Nr. /2020 Datë: **24.01.2020**

Në bazë të nenit 12 paragr. 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03 L-040 dhe nenit 41, paragr. 41.2 , shkronja "d" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, dhe vendimit të Kuvendit Komunal nr. **189/17** datë **29.06.2017** për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;
Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, z. Xhafer Tahiri dhe
Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame-Vushtrri, z. Shemsi Rrahimi,
lidhin këtë:

# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR KRYERJEN E RITEVE FTERAE TË VARRIMIT SI DHE SHËRBIMEVE DHE CEREMONIVE FETARE PËRCJELLËSE

## Neni 1.
## Qëllimi

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në bazë të vendimit nr. **189/17** datë **29.06.2017** mbi mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e riteve fetare të varrimit si dhe shërbimet përcjellëse të varrimit, autorizon dhe i jep në përgjegjësi Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri kryerjen e shërbimeve të varrimit në tërë territorin e komunës së Vushtrrisë.

## Neni 2.
## Obligimet e palëve:

**Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri:**

2.1 Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri obligohet që të kryejë ritet e varrimit si:

- Kryerjen e ritualeve të varrimit sipas traditave fetare islame.
- Pastrimin e kufomës,
- Qefinin,
- Dërrasat

- Piramidat me mbishkrim dhe
- Transportin e kufomës

Shpenzimet për të gjitha këto rite fetare do të përmblidhen në një faturë që Bashkësia Islame do të përgatitë për Komunën, duke përfshirë emrin e personit që ka vdekur si dhe shërbimet që i ka kryer Bashkësia Islame ( Transporti i kufomës brenda territorit të Vushtrrisë (nga shtëpia deri në xhami dhe prej aty në varreza dhe nga spitali (QKUK) në Prishtinë dhe aeroporti ndërkombëtar 'Adem Jashari"; transporti i punëtorëve dhe mjeteve të punës; dezinfektimi i veturës; Dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr; Qefini përfshirë këtu edhe dorëzat higjienike, sapunin dhe pambukun; Piramida (dërrasa me mbishkrimin e të dhënave për të vdekurin); Pastrimi i kufomës nga personi i autorizuar; Shërbimi i imamit (kryerja komplet e ceremonisë mortore). Shuma e faturës për ritet fetare të varrimit të cekura si më lartë është 180 € për një (1) person.
Për çdo person do të përgatitet faturë e veçantë.

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri obligohet që në fund të çdo muaji ti raportojë Komunës së Vushtrrisë, për rastet e vdekjeve si dhe të bëjë faturimin me kohë të faturave për pagesën e shërbimeve sipas këtij memorandumi; faturën dhe evidencën e personave të vdekur.

**Neni 3.**
**Obligimet e Komunës së Vushtrrisë**

1. Komuna e Vushtrrisë obligohet që për ritet dhe shërbimet e varrimit të paguajë shumën e specifikuar në Nenin 2 e dhe e cila i dërgohet Komunës në fillim të çdo muaji për muajin paraprak më së largu deri më datë 05 të muajit vijues.

1.1. Pagesa e shpenzimeve të shërbimeve duhet të bëhet nga data 01 deri 05 të muajit vijues në xhirollogarinë bankare të KBI-VUSHTRRI: **NLB BANKA VUSHTRRI, KBI VUSHTRRI I BASHKESIS ISLAME 1707-0010-112350.02.**

**Neni 4.**

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri obligohet që në fund të çdo muaji t'i raportojë Komunës së Vushtrrisë për rastet e vdekjeve si dhe të bëjë faturimin me kohë të faturave për pagesën e shërbimeve: faturën, evidencën e personave të vdekur dhe certifikatat nga libri amzë i të vdekurve.

**Neni 5.**

Memorandumi i Mirëkuptimit nuk e mbulon pagesa e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame.

**Neni 6.**

Për shërbime shtesë që kërkohen nga qytetarët dhe të cilat nuk janë të parapara në këtë memorandum, qytetarët obligohen t'i bartin individualisht shpenzimet.

**Neni 7.**

Memorandumi i Mirëkuptimit është i lidhur për afatin kohor një vjeçar me mundësi të vazhdimit dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

**Neni 8.**

Memorandumi i Mirëkuptimit mund të shkëputet njëanshëm nga ana e Komunës së Vushtrrisë me njoftim paraprak me shkrim në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh në rast se Këshilli i Bashkësisë islame nuk i respekton kriteret e respektuara në këtë memorandum apo në raste specifike dhe të arsyeshme.

**Neni 9.**

Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedh apo lidhet me këtë memorandum zgjidhet me mirëkuptim mes palëve kontraktuese. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim do të hapet kontest pranë Gjykatës kompetente.

**Neni 10.**

Çdo ndryshim i këtij memorandumi miratohet me shkrim nga palët kontraktuese.

**Neni 11.**

Ky memorandum nënshkruhet në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 189/17 datë 29.06.2017, për shpenzimet që do të mbulohen për një periudhë të pacaktuar ose deri në një vendim tjetër të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për këtë çështje.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në katër (2) ekzemplarë dhe do të ju dorëzohen nga 1 kopje origjinal palëve.

Palët-nënshkrimi-vula

| | |
|---|---|
| Xhafer Tahiri | Shemsi Rrahimi |
| Kryetar i Komunës së Vushtrrisë | Kryetar i BI-së Vushtrri |

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
307/20
16.03.2020
VUSHTRRI - VUČITRN

**KOMUNA VUSHTRRI**

**Këshilli i Bashkësisë Islame Vushtrri**

---

ANEKS MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
PËR KRYERJEN E RITEVE FETARE TË VARRIMIT SI DHE SHËRBIMEVE DHE CEREMONIVE FETARE PËRCJELLËSE

**Palët Nënshkruese:**

- Këshuilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri, përfaqësuar nga **Shemsi Rrahimi**, Kryetar
- Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës.

---

Neni 1

Me këtë Aneks Memorandum ndryshohet dhe plotësohet Memorandumi i mirëkuptimit për Kryerjen e Riteve Fetare të Varrimit si dhe Shërbimeve dhe Ceremonive Fetare Përcjellëse nr. 59/20, dt. 24.01.2020 në mes të komunës së Vushtrrisë dhe Këshuillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri si në vijim:

Fshihet neni 7 (shtatë) i Memorandumit të Mirëkuptimit për Kryerjen e Riteve Fetare të Varrimit si dhe Shërbimeve dhe Ceremonive Fetare Përcjellëse nr. 59/20, dt. 24.01.2020.

Neni 2

Ky Aneks Mmemorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Neni 3

Aneks Memorandumi është përpiluar në dy (2) ekzemplar në origjinal - një (1) për këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtrri dhe një (1) për Komunën e Vushtrrisë.

Më 16.03.2020

Këshilli i BI Vushtrri

**Shemsi Rrahimi, Kryetar**

Komuna Vushtrri

**Xhafer Tahiri**, Kryetar

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E VUSHTRRISË · OPŠTINA VUČITRN · REPUBLIKA KOSOVO

**Republika e Kosoves**
Republika Kosova-Republik of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opstina Vucitm - Municipality of Vushtrri

---

| | |
|---|---|
| Për: | Kuvendin e Komunës |
| Propozues: | Kryetari i Komunës ______ |
| Hartues: | DUMM ______ |
| Terna: | Propozim - Vendim |

---

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika "d" lidhur me nenin 17 pika "s" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040/2008, neni 41.2 . pika "9" të statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me __________ 2022. merr këtë:

**VENDIM**

**1.** Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, kiosqet nga druri që ipen në shfrytëzim nga komuna për më pak se një vit nga data 01.05.2022 deri më 25.04.2023.

**2.** Qëllim i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive të cilët operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen, Drejtoria për Buxhet e Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Inspektime.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

______________________

Kryesuese e Kuvendit te Komunës

ARSYETIM

Duke marrë parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike të këtyre veprimtarive si dhe bazuar në pasojat që ka shkaktuar pandemia Covid-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021, konsiderojmë që është e nevojshme që këto veprimtari të lirohen nga pagesa e taksës komunale.

Me respekt!

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Fortuna Krasniqi Spahiu

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës -Vushtrri**

**Për**: Kuvendin Komunal Vushtrri

**Propozues**: Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës ____________

**Hartues**: Abit Abiti, Zyrtar kryesor financiar____________

**Tema**: Propozim –Vendim për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligjit Nr. 08/l-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më____________**2022**, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR SHPËRNDARJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË TEJKALUARA PËR BUXHETIN E VITIT 2021**

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në kategoritë ekomomike të cekura si më poshtë:

1.1 Mallra dhe shërbime ........................................................................306,354.13 €

1.2 Shpenzime komunale..........................................................................9,994.73 €

1.3 Subvencione dhe transfere...............................................................593,966.26 €

1.4 Investime kapitale.............................................................................227,973.92 €

**Totali i mjeteve të tejkaluara...........................................................................1,138,289.04 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

____________________

**Kryesuese e Kuvendit**

# Arsyetim

Në këtë propzim-vendim janë të përfshira mjetet financiare që lidhen nga procesi i battjes së mjeteve finciare nga viti 2021 në vitin 2022 dhe shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021. Jemi kujdesur që kategoritë ekonomike mos të ndikohen negativisht, janë bartur mjetet financiare për projektet, për të cilat kemi kontrata dhe jemi përpjekur që me këtë bartje të mjetve t'i adresojmë rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.
Analitika e mjeteve për bartje është e specifikuar më lart sipas kategorive ekonomike, programe dhe projekte.

Andaj nga të cekurta më larët i propozojm kuvendit të komunës së që të aprovoj këtë prpozim vendim si në dispozitv të tij.

**Abit Abiti**

**Zyrtar Kryesor Financiar**

# Bartja e mjeteve të tejkaluara gjatë vitit 2021

## Komuna e Vushtrrisë

| Nën/Programi | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Fondi Burimor | Kategoria ekonomike | Nën kategorit ekonomike (zërat) | Kategoria | BARTJA 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtrri | 66425 | 0620 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 59,697.62 |
| Administrat-Arsimi | 92120 | 0980 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 246,656.51 |
| **Mallra dhe sherbime** | | | | | | | **306,354.13** |
| Infrastruktura publike | 18184 | 0451 | 22 | 14 | | Shpenzimet komunale | 9,994.73 |
| **Shpenzime komunale** | | | | | | | **9,994.73** |
| Zyra e kryetarit | 16024 | 0111 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 74,912.36 |
| Infrastruktura publike | 18184 | 0451 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 190,000.00 |
| Bujqësia | 47024 | 0421 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 192,670.00 |
| Administrata | 73033 | 0760 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 8,514.00 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 77,400.00 |
| Administrata | 92120 | 0980 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 8,999.90 |
| Shërbimet kulturore | 85024 | 0820 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 41,470.00 |
| **Subvencione** | | | | | | | **593,966.26** |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 30 | I RI | Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF | 85,940.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | I RI | Ndërtimi i shkollës në Gllavatin | 147,000.00 |
| **Kapitale** | | | | | | | **227,973.92** |
| **TOTALI** | | | | | | | **1,138,289.04** |

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës -Vushtrri**

**Për**: Kuvendin Komunal Vushtrri

**Propozues**: Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës ____________

**Hartues**: Abit Abiti, Zyrtar kryesor financiar____________

**Tema**: Propozim –Vendim për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligji Nr. 08/l-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më__________**2022**, mori këtë:

**VENDIM**
**PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2021 NË VITIN 2022**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në kategoritë si në vijim:

1.1 Mallra dhe shërbime ..........................................................................675,131.31 €

1.2 Shpenzime komunale............................................................................14,504.93 €

1.3 Subvencione dhe transfere..............................................................693,700.00 €

1.4 Investime kapitale..............................................................................1,190,675.47€

**Totali i mjeteve të bartura............................................................................2,574,011.71 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

____________________

**Kryesuese e Kuvendit**

## Arsyetim

Të barten mjetet e pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022 në vlerë 2,574,011.71€. Në këtë propzim-vendim janë të përfshira edhe mjetet financiare nga propozim-vendimi për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021. Jemi kujdesur që kategoritë ekonomike mos të ndikohen negativisht, janë bartur mjetet financiare për projektet, për të cilat kemi kontrata dhe jemi përpjekur që me këtë bartje të mjetve t'i adresojmë rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.
Analitika e mjeteve për bartje është e specifikuar më lart sipas kategorive ekonomike, programe dhe projekte.

**Abit Abiti**

**Zyrtar Kryesor Financiar**

# Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

**Komuna: Komuna e Vushtrrisë**

| Programi | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Fondi Burimor | Kategoria ekonomike | Kodi i projektit | Projektet | BARTJA 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Administrata - Vushtrri | 16324 | 0133 | 22 | 30 | 43890 | Inventar për objektin e ri të komunës | 4,200.00 |
| Administrata - Vushtrri | 16324 | 0133 | 22 | 30 | I Ri | Ndërtimi i sallës në objektin e komunës | 121,000.00 |
| Administrata - Vushtrri | 16324 | 0133 | 22 | 30 | 49479 | Ndërtimi i deposë | 30,000.00 |
| Infrastrukturë publike | 18184 | 0451 | 22 | 30 | 41407 | Ndërtimi i trotuareve | 2,500.00 |
| Infrastrukturë publike | 18184 | 0451 | 22 | 30 | 43900 | Projektet në bashkëfinancim me donatorë | 21,194.80 |
| Infrastrukturë publike | 18184 | 0451 | 22 | 30 | 46628 | Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit | 21,205.81 |
| Infrastrukturë publike | 18184 | 0451 | 22 | 30 | 47962 | Rregullimi i varrezave të martirëve | 5,192.00 |
| Infrastrukturë publike | 18184 | 0451 | 22 | 30 | 51202 | Rindërtimi i rrugëve me infrastrukturë | 1,125.82 |
| Infrastrukturë publike | 18184 | 0451 | 22 | 30 | 51826 | Blerja e veturave për administratën komunale – Vushtrri | 10,000.00 |
| Zjarrëfikësit dhe inspektimet | 18428 | 0320 | 22 | 30 | I RI | Renovimi i objektit të zjarrfikësve | 5,000.00 |
| Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural | 47024 | 0421 | 22 | 30 | 49561 | Projektet në bashkëfinancim me donatorë | 87,081.00 |
| Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural | 47024 | 0421 | 22 | 30 | 51203 | Ndërtimi i kanaleve kulluese në Lumadh dhe Dumnicë e | 5,439.65 |
| Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural | 47024 | 0421 | 22 | 30 | 51204 | Rr. i shtr.të lume. në Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë të Mes | 8,085.00 |
| Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural | 47024 | 0421 | 22 | 30 | 90231 | Rregullimi i lumenjve dhe argjinaturave | 16,360.58 |
| Planifikimi urban dhe inspeksioni | 66425 | 0620 | 22 | 30 | 41424 | Ndërt.rrug.lokale në fshatra | 161,998.30 |
| Planifikimi urban dhe inspeksioni | 66425 | 0620 | 22 | 30 | 45265 | Asfaltimi i rrugëve në qytet | 43,525.58 |
| Planifikimi urban dhe inspeksioni | 66425 | 0620 | 22 | 30 | I RI | Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc | 100,000.00 |
| Planifikimi urban dhe inspeksioni | 66425 | 0620 | 22 | 30 | 49579 | Rregullimi i hapësirave publike – shesheve | 5,552.57 |
| Planifikimi urban dhe inspeksioni | 66425 | 0620 | 22 | 30 | 49588 | Mbjellja e drunjve dekorativ | 13,044.33 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 30 | I RI | Rregullimi i hapësirave të rëntgenit - QKMF "Dr Safet Idrizi" | 50,000.00 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 30 | 41427 | Ndërtimi i QKMF në Vushtrri | 2,827.59 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 30 | I RI | Ndërtimi i deposë për mbeturina medicinale | 2,060.00 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 30 | I RI | Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF | 85,940.00 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 30 | 50059 | Automjet i terrenit për shëndetësi | 30,000.00 |
| Shërbimet sociale | 75616 | 1040 | 22 | 30 | 49628 | Renovimi i qendrës për kujdes ditor për të moshuar | 20,000.00 |
| Shërbimet Rezidenciale | 75617 | 1060 | 22 | 30 | 50984 | Renovimi i qendrës rezidenciale | 3,800.00 |
| Shërbimet kulturore | 85024 | 0820 | 22 | 30 | 46840 | Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi" | 50,000.00 |
| Shërbimet kulturore | 85024 | 0820 | 22 | 30 | 48361 | Ndërtimi i fushës ndihmëse te stadiumi i futbollit | 10,510.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | I RI | Ndërtimi i shkollës në Gllavatin | 147,000.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 41440 | Ndërtimi i rrethojave në shkolla | 2,878.14 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 46587 | Fusha sportive | 11,949.40 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 90282 | Meremetimi i shkollave | 5,541.94 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51008 | Ndërtimi i toaleteve në shkolla | 2,229.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 47970 | Salla sportive | 22,280.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 47909 | Ndërtimi i çerdhes së re | 39,557.60 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51866 | Meremetimi i SHF. "Ali Kelmendi" –Sudime | 10,000.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51873 | Meremetimi i SHFMU "Azem Bejta" - Beçiq | 4,000.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51858 | Depo për shf. "Naim Frashëri" | 7,796.36 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51859 | Depo për shf. „Latif Berisha" | 1,400.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51860 | Depo për shf. „Mustafë Shyti" | 1,400.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51865 | Meremetimi i shfmu. "Lumni Surdulli" | 6,000.00 |
| Arsimi fillor, i mesëm i ulët | 93690 | 0912 | 22 | 30 | 51872 | Meremetimi i shf "Naim Frashëri" dhe ndërtimi i toaleteve | 11,000.00 |
| | | | | | | TOTAL KAPITALE | 1,190,675.47 |

# Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

## Komuna e Vushtrrisë

| Nën/Programi | Kodi i nën-programit | Kodi Funksional | Fondi Burimor | Kategoria ekonomike | Nën kategorit ekonomike (zërat) | Kategoria | BARTJA 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zyra e kryetarit | 16024 | 0111 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 14,000.00 |
| Administrata -Vuishtrri | 16324 | 0133 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 37,000.00 |
| Inspeksioni | 16647 | 0411 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 10,000.00 |
| Prokuromi | 16820 | 0133 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 3,000.00 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 16924 | 0111 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 2,700.00 |
| Buxhetimi | 17524 | 0112 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 10,000.00 |
| Zjarrefiksat dhe inspektimet | 18428 | 0320 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 14,350.00 |
| Menaxhimi I fatkeqsive natyrore | 18468 | 0320 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 19,000.00 |
| Zyra lokale e Komuniteteve | 19620 | 1090 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 4,000.00 |
| Bujqësia | 47024 | 0421 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 17,000.00 |
| Shërbimet kadastrale | 65120 | 0610 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 8,000.00 |
| Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtrri | 66425 | 0620 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 94,000.00 |
| Administrata shëndetësi | 73033 | 0760 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 1,729.00 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 74,250.00 |
| Sherbimet sociale | 75616 | 1040 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 10,000.00 |
| Shërbimet Kulturore | 85024 | 0820 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 10,000.00 |
| Administrat-Arsimi | 92120 | 0980 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 248,016.00 |
| Arsimi parafillor - Qerdhja | 92670 | 0911 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 75,418.01 |
| Arsimi I Mesëm | 94890 | 0922 | 22 | 13 | | Mallra dhe shërbime | 22,668.30 |
| **Mallra dhe sherbime** | | | | | | | **675,131.31** |
| Infrastruktura publike | 18184 | 0451 | 22 | 14 | | Shpenzimet komunale | 10,000.00 |
| Administrata | 92120 | 0980 | 22 | 14 | | Shpenzimet komunale | 4,504.93 |
| **Shpenzime komunale** | | | | | | | **14,504.93** |
| Zyra e kryetarit | 16024 | 0111 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 125,000.00 |
| Infrastruktura publike | 18184 | 0451 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 190,000.00 |
| Bujqësia | 47024 | 0421 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 230,000.00 |
| Administrata | 73033 | 0760 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 10,000.00 |
| Shërbimet e shëndetësisë primare | 74450 | 0721 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 78,700.00 |
| Administrata | 92120 | 0980 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 10,000.00 |
| Shërbimet kulturore | 85024 | 0820 | 22 | 20 | | Subvencione dhe transferet | 50,000.00 |
| **Subvencione** | | | | | | | **693,700.00** |
| | | | | | | | |
| **Kapitale** | | | | | | | **1,190,675.47** |
| **TOTALI** | | | | | | | **2,574,011.71** |

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës ______
Hartues: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ______
Tema: Propozim – vendim

---

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 41 pika 41.2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën ____________ 2022 merr këtë:

# V E N D I M
## PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR KLUBIN E FUTBOLLIT "VUSHTRRIA"

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej pesëdhjetëmijë euro (50,000.00 €) për Klubin e Futbollit "Vushtrria" në Vushtrri.

2. Mjetet financiare të cekur si në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr.210/21 datë 06.10.2021.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi

______________________

Kryesues i Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosova ▪ Republic of Kosova

Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn ▪ Municipality of Vushtrri

**Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë**

**Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë**

**Hartues: Fortuna Krasniqi, Drejtoreshë e DUMM-së**

**Lënda: Propozim-vendim**

---

Bazuar ne Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, dhe nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 dhe 17 shkronja (c) dhe (f') të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 paragrafi 2 shkronja (ç) të Statutit të Komunës se Vushtrrisë, si dhe duke u bazuar ne Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me 28 prill 2022, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E TREGUT TË GJELBËR PËR PRODHIME VENDORE NË VUSHTRRI**

1. Me ketë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e tregut te gjelbër për prodhime vendore ne Vushtrri, në parcelat kadastrale: P-70202016-00504-0; 00505-0 dhe 00520-0, në sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 2400 $m^2$, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata e pronës dhe kopja e planit.

4. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi Nr.54/22 i datës 24.02.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri.

5. Ky vendim hynë ne fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit**

## ARSYETIM

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit pas analizave dhe studimeve të shumta të lokacioneve të ndryshme në qytet dhe konsultimeve me komunitetin e arkitektëve për përcaktimin e lokacionit për ndërtimin e tregut të gjelbër për prodhuesit vendor propozon lokacionin e lartëcekur, i cili është në qendër të qytetit, ku ka qasje të mirë nga rrugët kryesore përbrenda strukturës urbane dhe është i përshtatshëm për shfrytëzim në këmbë dhe biçikletë nga zonat e banimit, ka hapësirë të mjaftueshme për krijimin e parkingjeve, në afërsi ka parkun e qytetit, stadiumin "Musa Abazi", shkollat, si dhe zonat e banimit të lartë dhe të ulët.

Ndërtimi i tregut do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik, social e mjedisor, do të nxitë prodhimin e produkteve bujqësore në Komunën e Vushtrrisë, pasi që prodhuesve përmes dizajnit të projektit do t'iu ofrohet hapësira e nevojshme për promovimin dhe shitjen e produkteve të tyre.

Ndërtimi dhe zhvillimi i tregut në këtë lokacion do të ndikojë në rizhvillimin e lagjes urbane, zona përreth tregut do të trajtohet në atë mënyrë që t'i frymëzoj qytetarët që përderisa furnizohen me produktet e freskëta në treg, në të njëjtën kohë t'i shfrytëzojnë benefitet që ka kjo zonë, për të pasur një jetë shoqërore aktive.

Synimi është që ndërtimi i tregut të atraktoj më shumë njerëz, të nxisë shfrytëzimin e hapësirës publike përgjatë lumit, shfrytëzimin e stadiumit "Musa Abazi" parkun e qytetit dhe hapësirat komeraciale të cilat do të nxisin ndërveprimin pozitiv social dhe kulturor, forcojnë sigurinë e lagjes përmes ndriçimit dhe do të rrisin atraktivitetin e jetës në atë zonë, përfitimi do të jetë i dyanshëm si për shitësit po ashtu edhe për qytetarët.

Përmes dizajnit inovativ ndërtimi i tregut do të rigjenerojë të gjithë hapësirën ku do t'i ofrohet qasje e lehtë të gjitha grupmoshave. Rregullimi i oazave të gjelbërimit dhe drunjtë do të mundësojnë dritë-hije ku gjatë stinës së pranverës dhe verës do t'iu mundësohet shfrytëzimi i tezgave të hapura për shitjen e produkteve sezonale, fontana uji që rregullojnë mikro-klimën e hapësirës, ulëse, ndriçim, kënde lojërash për fëmijë dhe rekreacion, që do të shfrytëzohet nga banorët, vizitorët e zonës, shitësit, bleresit dhe të gjitha komunitetet pa dallim moshe, gjinie e etnie.

Drejtore e Drejtorisë për Urbanizëm
dhe Mbrojtje të Mjedisit

**Fortuna Krasniqi Spahiu**

# Lokacioni i tregut (propozim)




ZONË BANIMI
SHKOLLA
PARKU
SHESHI
LUMI TERSTENA
STADIUMI
TREGU i propozuar (Strukturë hapësinore)
MUNDESI ZGJERIMI ( me interes në të ardhmen)

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

18/1497

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : Komuna e Vushtrrisë

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **18-1487/22** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 26.04.2022 - 15:12 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name | Emri Ime First Name | Emri i babait Ime oca Father's Name | Gjinia Pol Gender | Nr. personal/ biznesit Lićni broj/broj poslovanja ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Vushtrrisë | | | / / | **600535001** | KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO | | | 28.12.2020 |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Adresa tjetër Druga adresa Other address | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI | | AHMET KRASNIQI | VUSHTRRI | 28.12.2020 |

## B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale<br>Katastarska jedinica<br>Cadastral unit | Komuna /<br>Opština /<br>Municipality | Zona kadastrale<br>Katastarska zona<br>Cadastral zone | Lloji i njësisë<br>Vrsta jedinice<br>Unit type | Tipi i pronës<br>Tip imovine<br>Property Type<br>/<br>Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property kind | Kati/<br>Katet<br>Br.Sprat a/<br>Spratova<br>Floor number | Vendi i quajtur<br>Zvano mesto<br>Place name | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Lloji i së drejtës<br>Vrsta prava<br>Type of the right | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70202016-00504-0** | VUSHTRRI /<br>VUĆITRN /<br>VUSHTRRI | Vushtrri /<br>Vushtrri /<br>Vushtrri | **PARCELË /<br>PARCELA /<br>parcel** | Pronë shoqërore<br>Drushtvena<br>Imovina<br>Socially owned<br>Land<br>/ | | VAROSH/MARSH ALA TITA / VAROSH/MARSH ALA TITA / VAROSH/MARSH ALA TITA | **6465** | Tokë Tjetër - Jo Pjellore - / / Ostalo Zemljiste - Neplodno - / / OtherLand - Unproductive - / / | **1 / 1** | Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasnistvo (1 Vl.) / Single Owner | |
| **P-70202016-00505-0** | VUSHTRRI /<br>VUĆITRN /<br>VUSHTRRI | Vushtrri /<br>Vushtrri /<br>Vushtrri | **PARCELË /<br>PARCELA /<br>parcel** | Pronë shoqërore<br>Drushtvena<br>Imovina<br>Socially owned<br>Land<br>/ | | VAROSH/MARSH ALA TITA / VAROSH/MARSH ALA TITA / VAROSH/MARSH ALA TITA | **2794** | Tokë Ndërtimore - Shtëpi-Ndërtese - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Kuca-Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - BackYard - / / | **1 / 1** | Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasnistvo (1 Vl.) / Single Owner | |
| **P-70202016-00520-0** | VUSHTRRI /<br>VUĆITRN /<br>VUSHTRRI | Vushtrri /<br>Vushtrri /<br>Vushtrri | **PARCELË /<br>PARCELA /<br>parcel** | Pronë shoqërore<br>Drushtvena<br>Imovina<br>Socially owned<br>Land<br>/ | | VAROSH/ M.TITA /<br>VAROSH/ M.TITA /<br>VAROSH/ M.TITA | **713** | Tokë Ndërtimore - Shtëpi-Ndërtese - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Kuca-Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - BackYard - / / | **1 / 1** | Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasnistvo (1 Vl.) / Single Owner | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtrri

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202016-00504-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 6465 |
| P-70202016-00520-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 713 |
| P-70202016-00505-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 2794 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1096

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 26.04.2022
Koha/ Vreme/ Time: 03:09:57
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Parku i Qytetit
Siperfaqja prej 24.00 ari
Reka Terstena